

Procedurat Standarde të Veprimit për Emigrimin për Motive Punësimi

Tabela e përmbajtjes

Shkurtime	3
Përkufizime	4
1. Parathënie	5
2. Konteksti i vendit	6
3. Objektivi dhe qëllimi i PSV-së	8
4. Parimet dhe standardet e PSV-ve	9
5. Fusha e zbatimit, grupet e synuara dhe qëllimi i PSV-ve.....	10
6. Standardet ndërkombëtare	13
7. Kuadri kombëtar ligjor, institucional dhe i politikave.....	16
8. Struktura dhe përshkrimi i PSV-ve	26
PSV 1 Ofrimi i informacionit në internet dhe komunikimi me emigrantët potencialë	28
PSV 2 Shërbimet e drejtpërdrejta dhe në internet për emigrantët potencialë	33
PSV 3 Mbledhja e të dhënave dhe rritja e kapaciteteve të Njesisë për Migracionin dhe Diasporës për ofrimin më të mirë të shërbimeve për emigrantët potencialë	50
Shtojca 1: Formulari i vlerësimit	54

Shkurtime

KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
GCM	Pakti Global për Migracionin
QSH	Qeveria shqiptare
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
MB	Ministria e Brendshme
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MM	Memorandum Mirëkuptimi
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
BP	Ballkani Perëndimor
BP6	Gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor

Përkufizime

Për qëllimet e këtij dokumenti, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Emigrim për motive punësimi” është largimi me dëshirë i shtetasit shqiptar nga territori i Republikës së Shqipërisë për t’u punësuar, vetëpunësuar, për t’u formuar profesionalisht nëpërmjet punës në një shtet tjetër ose për t’u ribashkuar me pjesëtarin e familjes që ka emigruar.¹

“Emigrim i rregullt” është lëvizja e një personi nga territori i Republikës së Shqipërisë në një vend tjetër, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore, që rregullojnë daljen nga vendi i origjinës, udhëtimin, kalimin tranzit, hyrjen dhe qëndrimin në vendin pritës.²

“Menaxhimi i emigrimit” është procesi i hartimit, harmonizimit dhe zbatimit të politikave, akteve ligjore dhe administrative.³

“Emigrant potencial” është personi qëllimi i të cilit është të punësohet ose vetëpunësohet në mënyrë të rregullt në një aktivitet fitimprurës ose jofitimprurës apo publik me ose pa afat në një vend tjetër.

“Vend pritës” është vendi ku shtetasi shqiptar do të punësohet ose mund të punësohet, pavarësisht llojit të kontratës së punës.

“Grupe të marginalizuara” janë kategoria e emigrantëve më të ekspozuar për t’u vënë në shënjestër të trafikimit.⁴

“Migrantë në situatë vulnerabël” janë migrantët të cilët nuk janë në gjendje të gëzojnë në mënyrë efektive të drejtat e tyre të njeriut, përballen me rrezikun në rritje të shkeljeve dhe abuzimit dhe, si pasojë, kanë të drejtën të kërkojnë një nivel më të lartë kujdesi nga ata që mbajnë detyrën..⁵

“Kurse formimi orientuese” janë kurset për formim profesional, gjuhësor dhe njohuri të tjera, për të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve emigrantë, si dhe për kulturën dhe kushtet e punës në vendin pritës, në territorin e Republikës së Shqipërisë, para nisjes, deri në trejavë, intensive, vetëm për shtetasit, që kanë siguruar një kontratë pune jashtë vendit dhe janë në pritje të largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë, si dhe për pjesëtarët e familjes së tyre, që do të emigrojnë apo do të ribashkohen me ta.⁶

¹ Shkëputur nga Ligji Nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, i ndryshuar nga Ligji 10389, datë 03.03.2011 ;

² Shkëputur nga the Ligji Nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, i ndryshuar;

³ Përshtatur nga përkufizimi i termit parashikuar në Ligjin Nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, i ndryshuar;

⁴ Shkëputur nga the Ligji Nr. 10389, datë 03.03.2011, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9668, datë 18.12.2006, ‘Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi’”;

⁵ Fjalorthi i IOM-it, 2019.

⁶ Shkëputur nga the Ligji Nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, i ndryshuar;

1. Parathënie

Shtetasit shqiptarë do të vazhdojnë të kërkojnë mundësi punësimi jashtë vendit, një prirje me efekt domethënës në rrugën e zhvillimit të vendit. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi për periudhën 2023-2030,⁷ e cila përshkruan faktorët që ndikojnë në emigrimin për motive ekonomike të shtetasve shqiptarë, vëren se të rinjtë i krahasojnë kushtet e punës në vend me alternativën e emigrimit. Kjo, më pas, vepron si pengesë për ta që të hyjnë në tregun e punës në Shqipëri dhe i nxit të largohen. Fluksi i madh i emigrimit dalës dobëson bazën e fuqisë punëtore, sidomos tek të rinjtë. Po kështu, emigracioni ka sjellë si rezultat edhe uljen e numrit të studentëve që ndjekin arsimin parauniversitar dhe të lartë në Shqipëri, çfarë sërish do të ketë ndikim në të ardhmen e tregut të punës. Strategjia del gjithashtu në përfundimin se ndryshimi i profilit të individëve që zgjedhin të emigrojnë në vendet e huaja ka ndryshuar përgjatë viteve, duke krijuar mungesa aftësitë që kërkohen në tregjet e huaja të punës. Ndryshe nga dy dekada më parë, gjatë dhjetëvjeçarit të shkuar, lëvizja e lirë, si dhe rritja e kërkesës në vendet e BE-së për punonjës të kualifikuar, i ka nxitur personat që kanë investuar në arsimimin dhe aftësitë e tyre të kërkojnë punë më të mira dhe më të paguara në ekonomi më të zhvilluara.

Për rrjedhojë, ekziston një nevojë e ngutshme për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe institucional që trajton emigracionin. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional është thelbësor, jo vetëm për të informuar dhe orientuar individët drejt kanaleve të rregullta të migracionit, por edhe për të garantuar migracion të sigurt, të organizuar dhe të rregullt. Kjo do të kontribuojë në zbutjen e rreziqeve që shoqërojnë migracionin e parregullt, si trafikimi dhe shfrytëzimi i qenieve njerëzore. Përveç kështu, një kuadër i mirëstrukturuar mund të nxisë përdorimin efikas të kapitalit njerëzor, pasi individët që emigrojnë për motive punësimi mund të kontribuojnë pozitivisht si në ekonominë shqiptare, ashtu edhe në zhvillimin e vendit të tyre pritës. Për më tepër, rregullimi i emigracionit mund të ndihmojë në trajtimin e pabarazive gjinore dhe të sigurojë që të gjitha segmentet e shoqërisë, duke përfshirë gratë dhe pakicat, të kenë qasje të barabartë në mundësi dhe në mbrojtje. Kjo qasje është në harmoni me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe migracionin, duke nxitur përfshirjen dhe kohezionin social në shoqërinë shqiptare.

Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme që zhvillimi i kuadrit institucional të shtrihet gjithashtu në nivelin vendor.. Në këtë mënyrë, bashkitë mund të bëhen një prej faktorëve të rëndësishëm që mundësojnë migracionin e sigurt dhe të organizuar dhe t'i përmbahen parimit të qasjes mbarëqeveritare, si dhe të kontribuojnë për informimin mbi përparimin socioekonomik të migrantëve në shtetin e tyre.⁸

Promovimi i këtyre mundësive është me dobi jo vetëm për individët, të cilët mund të mos jenë në dijeni të këtyre mundësive, por edhe jetike për zhvillimin e komuniteteve vendore dhe të

⁷ VKM Nr. 173, datë 24.03.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të Garancisë Rinore 2023-2024";

⁸ MiGoV, IOM, gjendet në https://www.iom.int/sites/g/files/tmzbd1486/files/about-iom/migof_brochure_a4_en.pdf;

shtetit në tërësi. Prezantimi i disponueshmërisë të programeve cilësore të arsimit dhe formimit profesional, nismave për nxitjen e punësimit dhe burimeve të garantuara për rininë që kanë në qendër fuqizimin e të rinjve, qasjes në programet e sipërmarrjes të mbështetura nga qeveria, ndihmës financiare për bizneset e vogla dhe nismave që synojnë të nxitin ekonominë vendore, mund t’iu ofrojë emigrantëve potencialë alternativa për emigrim. Duke i komunikuar këto mundësi në mënyrë efektive, zyrtarët bashkiakë mund t’i ndihmojnë emigrantët potencialë të shohin vlerën e qëndrimit dhe dhënies së kontributit për zhvillimin e shtetit të tyre. Më tej, duke ofruar informacion të besueshëm rreth mundësive, rregullave dhe procedurave të emigrimit të përcaktuara nga vendet e huaja për procesin e migracionit dhe duke i’usiguruar shërbime emigrantëve potencialë, bashkitë sigurojnë që emigrantët të zgjedhin rrugët e migracionit të sigurt dhe të fuqizohen për të realizuar të drejtat e tyre në disa nivele (të drejtat e punësimit, shoqërore, kulturore) në vendet e destinacionit.

2. Konteksti i vendit

Emigrimi për motive punësimi nga Shqipëria, si dhe nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6), ka qenë i konsiderueshëm ndër dekada. Aktualisht, një e pesta e popullsisë së lindur në rajonin e BP6-ës jeton jashtë shtetit të tyre.⁹ Mesatarisht, më shumë se gjysma e të gjithë migrantëve nga Ballkani Perëndimor me qëndrim në shtetet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) janë të punësuar në vende pune me kualifikim mesatar.¹⁰ Rreth një e pesta bëjnë punë me kualifikim të ulët dhe një e pesta tjetër janë pozicione me kualifikim të lartë.¹¹ Sektorët më të zakonshëm të punësimit për migrantët meshkuj nga Ballkani Perëndimor në vendet e OECD-së përfshijnë ndërtimin dhe profesionet e lidhura me të, si dhe punëtorë në prodhim. Për femrat migrante, punët më të shpeshta janë rolet ndihmëse dhe në pastrim, shitje, punët e shërbimit dhe kujdesit personal dhe profesionet si ndihmëse shëndetësore.

Emigracioni ka një ndikim të rëndësishëm në popullsinë e Shqipërisë. Sipas Institutit shqiptar të Statistikave¹², vlerësohet se gjatë periudhës 2011-2021, çdo vit kanë emigruar mesatarisht dyzet e dy mijë persona. Koeficienti i emigracionit, që tregon numrin e emigrantëve që largohen nga vendbanimi për 1,000 banorë të vendbanimit në një vit të dhënë, ka shfaqur një prirje rritëse gjatë viteve të fundit, nga 15,4 në vitin 2019, në 16,7 në vitin 2022¹³. Megjithatë, është e vështirë të sigurosh shifrat e sakta të lëvizjeve të rregullta migratore dhe kjo përbën sfida për autoritetet

⁹ Labour Migration in the Eastern Balkans: Mapping Patterns, Addressing Challenges and Reaping Benefits, OECD 2022, gjendet në <https://www.oecd.org/south-east-europe/programme/labour-migration-report.pdf>, konsultuar më 5 qershor 2024;

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty.

¹² <https://www.instat.gov.al/al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB/>;

¹³ VKM Nr. 50, datë 31.01.2024, “Për miratimin e Profilit të Zgjeruar Kombëtar të Migracionit për periudhën 2019-2022”;

qendrore dhe vendore, për shkak të mungesës së një mekanizmi regjistrimi të migrantëve përpara nisjes.

Pavarësisht disa përparimeve në pikëpamjen ekonomike dhe sociale, vështirësitë socioekonomike vazhdojnë të jenë faktorë shtytës të emigrimit nga Shqipëria. Nivelet e larta të papunësisë, pagat relativisht të ulëta, rezultatet e dobëta arsimore, sigurimet e pamjaftueshme shoqërore dhe korrupsioni mbeten faktorë kyç për nxitjen e emigrimit. Në të njëjtën kohë, rrjetet e ngritura të migracionit, kërkesa e vazhdueshme për fuqi punëtore në vendet evropiane dhe politikat migratore, që targetojnë specifikisht migrantët për motive punësimi, i kanë ulur pengesat për emigrim në një sërë vendesh destinacioni.

Emigracioni aktual shqiptar karakterizohet nga forma të ndryshme emigrimi, duke përfshirë punësimin e rregullt sezonal apo afatgjatë, bashkimin familjar dhe studimet. Shqipëria vijon të përjetojë një shkallë të lartë të emigrimit familjar, përfshirë gratë dhe fëmijët. Kjo prirje mbështetet nga afërsia kulturore, gjuhësore dhe gjeografike, kostoja e ulët e migrimit në vende fqinjë si Italia dhe Greqia dhe mundësitë ligjore për bashkim familjar në vendet kryesore pritëse¹⁴. Përveç kësaj, shkalla e lartë e emigrimit të profesionistëve të kualifikuar, sidomos në sektorin e kujdesit shëndetësor, është një tipar i ri i migracionit shqiptar.

Ndërkohë, emigrimi i parregullt nga Shqipëria drejt vendeve të tjera, kryesisht brenda Bashkimit Evropian, vazhdon të jetë i pranishëm. Kjo vërtetohet nga numri i personave të ndaluar në kufi dhe brenda territoreve të huaja, si edhe shifrat vjetore të kthimeve të detyruara. Sipas të dhënave të Eurostat-it, periudha 2019-2022 shënoi një ulje domethënëse të qëndrimeve të parregullta, me 7,52%, por vitin që pasoi (2021) u vërejt një rritje me 10%.¹⁵ Kjo luhatje tregon sfidat e vazhdueshme të menaxhimit të flukseve të migrimit të parregullt dhe thekson nevojën për përpjekje të vazhdueshme për trajtimin e faktorëve nxitës që qëndrojnë në themelin e migrimit të rregullt dhe të parregullt.

Në dritën e këtyre prirjeve, është domosdoshmëri që Shqipëria të përqendrohet tek përgatitja dhe dhënia e ndihmës përpara nisjes për emigrantët potencialë. Kjo përgatitje duhet të përfshijë informacione gjithpërfshirëse mbi rrugët e ligjshme të migrimit, mundësitë e punësimit dhe rreziqet që shoqërojnë migrimin e parregullt. Forcimi i programeve të trajnimit përpara nisjes, që i pajisin emigrantët me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për t'u integruar me sukses në vendet pritëse, është thelbësor. Përveç kësaj, rritja e bashkëpunimit me vendet e destinacionit për të garantuar ngritjen e sistemeve mbështetëse mund të ndihmojë për të zbutur sfidat me të cilat ndeshen emigrantët. Përmes trajtimit të këtyre nevojave, Shqipëria mund të menaxhojë më mirë flukset e saj migratore, të mbështesë mirëqenien e qytetarëve të saj jashtë dhe të shtojë përfitimet e përgjithshme të migracionit si për individët, ashtu edhe për vendin.

¹⁴ VKM Nr. 50, datë 31.01.2024, "Për miratimin e Profilin të Zgjeruar Kombëtar të Migracionit për periudhën 2019-2022";

¹⁵ Po aty.

3. Objektivi dhe qëllimi i PSV-së

Objektivi i përgjithshëm i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV-të) është:

Të standardizojnë dhe të përmbledhin procedura për një qasje ndërsektorale që përmirëson kuadrin institucional dhe kapacitetet e pushtetit vendor për migracionin e rregullt të shtetasve shqiptarë për motive punësimi, duke ndërmarrë një angazhim të fortë për integrimin gjinor dhe përfshirjen e popullsisë të pakicave; të garantojnë përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të gjithëpranuara të të drejtave të njeriut dhe të sigurojnë përputhjen me ligjet, strategjitë, procedurat dhe protokollet kombëtare përkatëse.

Qëllimi i këtyre PSV-ve është:

Të hartojë një grup procedurash të qarta dhe gjithpërfshirëse në mbështetje të autoriteteve vendore, në bashkëpunim me institucionet qendrore, për t'iu ofruar ndihmë emigrantëve potencialë, që planifikojnë të udhëtojnë jashtë vendit për motive punësimi.

Këto PSV janë hartuar për të ardhur në përputhje me funksionet dhe detyrat e njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe objektivat strategjike vendore dhe qendrore në fushën migracionit. Për rrjedhojë, ato janë një instrument thelbësor për të mbështetur si veprimtaritë e përditshme, ashtu edhe objektivat strategjike.

Hartimi, miratimi dhe zbatimi i PSV-ve do të kontribuojë për një qasje të strukturuar të bashkive në kryerjen e detyrave dhe proceseve që lidhen me migracionin. Këto procedura synojnë të plotësojnë kuadrin ligjor dhe strategjik në fuqi, me qëllimin për të siguruar që emigrantët të jenë të mirinformuar, mjaftueshëm të përgatitur dhe të mbështetur gjatë gjithë procesit, për të rritur sigurinë dhe mirëqenien e tyre. Procedurat standarde të veprimit janë themelore për të garantuar që të gjithë profesionistët të ndjekin të njëjtat udhëzime, çfarë ndihmon për ruajtjen e një standardi të lartë cilësie të shërbimeve të dhëna. Duke ofruar udhëzime të detajuara, hap pas hapi, PSV-të nxitin njëtrajtshmërinë dhe cilësinë në të gjitha aspektet.

Për më tepër, këto PSV kanë për synim të përmirësojnë efikasitetin e bashkive duke parashikuar për profesionistët bashkiakë mënyrat më efikase për kryerjen e detyrave të tyre dhe përmbushjen e përgjegjësisë të tyre në bashkëpunim me autoritetet qendrore. Kjo ul kohën dhe përpjekjet e nevojshme, minimizon gabimet dhe shmang përsëritjet e panevojshme, duke çuar në rritjen e produktivitetit dhe njëjësimit të veprimtarive.

Së fundmi, ato mund të shërbejnë po ashtu si një mjet i vlefshëm trajnimi për nëpunësit e rinj, duke i'uofruar një ide të qartë të përgjegjësisë dhe procedurave që duhet të ndjekin.

4. Parimet dhe standardet e PSV-ve

Përveç parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe parimeve specifike të parashikuara në legjislacionin për emigrimin dhe punësimin, Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për emigrimin për motive punësimi synojnë të krijojnë një mjedis ku të gjithë kanë mundësi t'ia dalin. PSV-të mbështeten në parimet e mëposhtme:

- **Lehtësia në qasje, barazia, mosdiskriminimi dhe përfshirja:** Të gjithë emigrantëve potencialë në kërkim të informacionit dhe mbështetjes, i'ugarantohet qasje e barabartë në burime dhe shërbime pa asnjë formë diskriminimi. Shërbimet e ofruara garantojnë përmbushjen e nevojave të ndryshme të të gjithë emigrantëve potencialë, përfshirë gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat etnike dhe çdo individ, pavarësisht prejardhjes, gjinisë, etnisë, aftësisë së kufizuar apo statusit ekonomik e shoqëror të tij/saj, trajtohet në mënyrë të drejtë dhe me respekt, duke u siguruar që informacioni mbi mundësitë dhe të drejtat të jetë lehtësisht i kuptueshëm.
- **Mbështetje e individualizuar:** Procesi i emigrimit për motive punësimi udhëhiqet nga një qasje e individualizuar, tërësore që merr në konsideratë rrethanat unike të secilit individ dhe familjeve të tyre. Kjo qasje vendos si përparësi mbështetjen e personalizuar dhe empatike, që siguron që emigrantët të përfitojnë informacionin e nevojshëm dhe referencat e përshtatshme lidhur me procesin e migrimit, duke i fuqizuar ata të marrin vendime të informuara dhe të orientohen nëpër procesin e emigrimit me besim dhe lehtësi.
- **Subsidiariteti:** Shërbimet për emigrantët potencialë ofrohen në nivelin më të afërt dhe vendor për të trajtuar nevojat e tyre në mënyrë efektive, që synon të rrisë aksesin dhe aftësinë reaguese, ndërkohë që fuqizojnë bashkitë vendore për të administruar aspekte të caktuara të procesit të emigracionit, që trajtojnë sfidat specifike me të cilat përballen emigrantët.
- **Qasja ndërinstitucionale:** Ndihma efektive për emigrantët potencialë kërkon bashkëpunim dhe koordinim të vazhdueshëm midis të gjitha subjekteve përkatëse, për të ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse përmes shërbimeve të integruara, komunikimit ndërinstitucional dhe koherencës së politikave. Rritja e vazhdueshme e kapaciteteve dhe angazhimi aktiv i aktorëve janë thelbësorë për të siguruar harmonizimin e përpjekjeve dhe të burimeve, duke i lejuar institucionet të krijojnë një kuadër mbështetës që fuqizon emigrantët për të marrë vendime të informuara dhe për të përshkuar me sukses rrugëtimin e tyre të emigracionit.

Standardet që orientojnë punën e nëpunësve të bashkisë janë si vijon:

- **Qasje profesionale dhe miqësore:** Nëpunësit duhet të mbajnë një qëndrim profesional por sidoqoftë të afrueshëm, duke treguar vëmendje dhe ndjeshmëri kundrejt rrethanave të çdo individi.
- **Informacion dhe shërbime të personalizuar:** Informacioni dhe shërbimet duhet të personalizohen sipas situatës dhe nevojave të individit, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.
- **Ndërtimi i besimit dhe respektit:** Nëpunësit duhet të krijojnë një raport besimi me individët, duke i trajtuar gjatë gjithë kohës me respekt.
- **Komunikimi efektiv:** Nëpunësit duhet të angazhohen në mënyrë aktive në komunikim, duke u përpjekur të kuptojnë qartësisht situatën e individit dhe duke ofruar shërbimin, informacionin dhe referimet e përshtatshme.
- **Të nxënit dhe përmirësimi i vazhdueshëm:** Nëpunësit duhet të përfitësojnë dijet dhe praktikën e tyre mbështetur në mësimet e nxjerra nga përvojat e mëparshme, si dhe t'i ndajnë këto njohuri me kolegët e tyre me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm.
- **Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave:** I gjithë informacioni duhet trajtuar në mënyrë konfidenciale dhe duhet marrë pëlqimi i personit, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.
- **Dokumentimi i saktë:** Nëpunësit duhet t'i plotësojnë saktë formularët, kur intervistojnë emigrantët potencialë, duke u siguruar që i gjithë informacioni të regjistrohet si duhet.

5. Fusha e zbatimit, grupet e synuara dhe qëllimi i PSV-ve

Fusha e zbatimit të PSV-ve është e kufizuar përgjithësisht në nivelin bashkiak. Arsyeja për këtë fushëzbatim të kufizuar është se bashkitë janë të rëndësishme në përfshirjen në veprimtaritë e zakonshme, ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi që lidhen me dhënien e ndihmës për emigrantët për të planifikuar udhëtimin e tyre për motive punësimi, si dhe, fakti që bashkitë luajnë një rol thelbësor në koordinimin me një mori aktorësh, përfshirë institucionet publike, subjektet private dhe organizatat jofitimprurëse. Ky koordinim është thelbësor për t'u siguruar që emigrantët të marrin mbështetje të gjithanshme, duke shfrytëzuar burime të larmishme dhe

ekspertizën e disponueshme brenda komunitetit. Megjithatë, pavarësisht ilustrimit të bashkëpunimit horizontal midis institucioneve vendore, ato tregojnë gjithashtu bashkëpunimin vertikal midis nivelit vendor dhe qendror, që është fakt i pamohueshëm për mbarëvajtjen e funksionimit të këtyre strukturave vendore.

Edhe pse PSV-të janë hartuar duke synuar emigrantët potencialë për motive punësimi, duke patur parasysh se njerëzit mund të emigrojnë fillimisht për motive të tjera nga ai i punësimit, përfituesit kryesorë të shërbimeve dhe sistemit të referimit që rregullohen nga këto PSV do të jenë emigrantët potencialë për motivet e mëposhtme:

- Punësim,
- Studim dhe
- Bashkimi familjar.

Këto procedura janë konceptuar për të ofruar një kuadër të strukturuar dhe mbështetës, që ndihmon emigrantët në mbarëvajtjen e rrugëtimit të tyre drejt punësimit jashtë vendit. Këtu përfshihet ofrimi i orientimit për kurset e formimit përgatitor, subjektet e specializuara për ofrimin e ndihmës profesionale për emigrantët potencialë, kriteret ligjore dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe për dhënien e informacionit mbi të drejtat dhe garancitë mbrojtëse në vendin e destinacionit.


Synimi i PSV-ve është i dyfishtë:

- ✓ ***të nxisin një mjedis ku emigrantët të mund të përfitojnë një gamë të gjerë shërbimesh të personalizuar për nevojat e tyre specifike dhe;***
- ✓ ***të krijojnë një bazë për rritjen e kapaciteteve të strukturave vendore të migracionit dhe të diasporës përmes një bashkëpunimi më të mirë horizontal dhe vertikal me institucionet përkatëse në nivel vendor dhe qendror.***

1. PSV-të synojnë t'i pajisin bashkitë për të krijuar një sistem tërësor mbështetëse që trajton sfidat shumëplanëshe me të cilat përballen emigrantët. Këtu përfshihet orientimi përpara nisjes, formimi i aftësive, kurset e gjuhës dhe programet e integritit kulturor, që sigurojnë që emigrantët të jenë të mirëpërgatitur për mjediset e tyre të reja, si edhe që të ruhet një komunikim i vazhdueshëm me emigrantët gjatë gjithë rrugëtimit të tyre.

2. PSV-të synojnë të rrisin bashkëpunimin midis institucioneve në nivel vendor e qendror, të përmirësojnë regjistrimin dhe mbajtjen e statistikave për migracionin, që janë thelbësore për të kuptuar prirjet migratore, të hartojnë marrëveshje dypalëshe dhe të planifikojnë shërbime të përshtatshme mbështetëse. Ky fokus tek mbledhja dhe komunikimi i të dhënave është në linjë edhe me objektivat më të gjera të bashkive për të përfituar nga potenciali i emigrantëve për të kontribuar në ekonominë vendore dhe institucionet qendrore, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Migracionin, 2023-2027 dhe Planin e Veprimit.

Figura 1 Synimi i PSV-ve



6. Standardet ndërkombëtare

Karta e të Drejtave, e cila përmban Deklaratën Universale të të Drejtave të njeriut, e cila nuk është e detyrueshme ligjërish (edhe pse shumica e dispozitave të saj përgjithësisht njihen si elemente përbërëse të së Drejtës Ndërkombëtare), si dhe dy traktatet e përgjithshme për të drejtat e njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (ICESCR), mbrojnë të gjitha qeniet njerëzore, pavarësisht kombësisë dhe statusit të tyre juridik, përfshirë punonjësit migrantë, si josh tetas të cilët, përgjithësisht, gëzojnë të njëjtat të drejta njerëzore si shtetasit.¹⁶ Edhe pse Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punonjësve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre (ICRM) (1990)¹⁷ është instrumenti i vetëm i OKB-së që i'ukushtohet drejtpërdrejtë punonjësve migrantë, ka edhe një sërë instrumentesh të tjera të kësaj organizate që kanë rëndësi potenciale sa i përket mbrojtjes së migrantëve nga diskriminimi dhe shfrytëzimi. Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (ICERD) (1965)¹⁸ parashikon detyrimin e shteteve të cilat janë palë për të përcaktuar si të jashtëligjshëm diskriminimin për shkak të racës, ngjyrës, prejardhjes apo origjinës kombëtare ose etnike kundër të gjithë individëve brenda juridiksionit të shtetit dhe për të marrë masa ndëshkuese kundër veprimtarive që bazohen në një diskriminim të tillë. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) (1979)¹⁹ ndalon diskriminimin mbi bazën e gjinisë dhe gjen zbatim për të gjitha gratë, përfshirë gratë migrante, pasi vendet e punës me specifikë gjinore apo sektorët e punës ku mbizotërojnë ato janë veçanërisht të ekspozuara ndaj abuzimit. Skllavëria dhe puna e detyruar ose e detyrueshme e punonjësve migrantë ndalohet nga e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut dhe instrumentet e posaçme ndërkombëtare kundër skllavërisë dhe praktikave skllavëruese.

Megjithatë, sa i takon periudhës përpara nisjes që është edhe objekti i këtyre PSV-ve dhe ofrimit të mbrojtjes gjatë procesit të migracionit përpara nisjes, shtetet kanë miratuar pesë instrumente të përditësuara (dy konventa dhe tre rekomandime), veçanërisht për punonjësit migrantë:

¹⁶ Deklarata u shpall nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor 1948 (Rezoluta 217 A e Asamblesë së Përgjithshme) si një standard i njëjësuar i arritjeve për të gjithë popujt dhe të gjitha kombet. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 16 dhjetor 1966, Rezoluta 2200A e Asamblesë së Përgjithshme (XXI), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore, 16 dhjetor 1966, Rezoluta 2200A (XXI) e Asamblesë së Përgjithshme.

¹⁷ Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punonjësve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjes së Tyre, 18 dhjetor 1990, Rezoluta 45/158 e Asamblesë së Përgjithshme.

¹⁸ Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, 21 dhjetor 1965, Rezoluta 2106 (XX) e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara

¹⁹ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Nju Jork, 18 dhjetor 1979, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

- Konventa (Nr. 97) për Migracionin për Motive Punësimi (E rishikuar), 1949 dhe Rekomandimi (Nr. 86) (i rishikuar), 1949²⁰
- Rekomandimi (Nr. 100) për Mbrojtjen e Punonjësve Migrantë (vendet e pazhvilluara), 1955²¹
- Konventa për Punonjësit Migrantë (Nr. 143) (Dispozita Shtesë), 1975 dhe Rekomandimi (Nr. 151) për Punonjësit Migrantë, 1975.²²
- Konventa Nr. 118 për Trajtimin e Barabartë (sigurimet shoqërore).
- Konventa Nr. 102 për Sigurimet Shoqërore (Standardet minimale).

Republika e Shqipërisë i ka ratifikuar të gjitha konventat e lartpërmendura të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP), të cilat luajnë rol thelbësor për mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve potencialë. Këto konventa synojnë të sigurojnë një trajtim të drejtë, mundësi të barabarta dhe mbrojtje nga shfrytëzimi, të ndalojnë diskriminimin në punësim dhe punë mbi bazën e racës, ngjyrës, gjinisë, besimit fetar, bindjeve politike, prejardhjes kombëtare apo origjinës shoqërore, të garantojnë barazi në trajtim në çështjet e sigurimeve shoqërore për punonjësit migrantë duke i'uofruar të njëjtat përfitime nga sigurimet shoqërore si shtetasit e vendit pritës dhe të vendosin standardet minimale për fusha të ndryshme të sigurimeve shoqërore, përfshirë kujdesin shëndetësor, përfitimet për sëmundjet, përfitimet e papunësisë, përfitimet e moshës së vjetër dhe përfitimet familjare.

Këto konventa dhe rekomandime përcaktojnë të drejtat përpara nisjes dhe shënjestrojnë rrezikun e shfrytëzimit të migrantëve përpara sesa të largohen nga vendi i tyre. Shpesh, atyre i'umungon informacioni i saktë rreth vendeve të punës dhe kushteve të punës e jetesës jashtë vendit dhe nuk janë të mirinformuar mbi procesin kompleks të largimit jashtë. Shpesh, ata mbitarifohen për procesin e hartimit të dokumenteve, e kanë të vështirë të bëjnë dallimin midis agjencive të mirëfillta të punësimit nga agjentët mashtrues apo krimi i organizuar ose detyrohen t'i nënshtrohen një procesi që është në shkelje të të drejtave të njeriut (p.sh., izolimi në të ashtuquajturat 'qendra rekrutimi'). Rreziqet e trafikimit janë mbizotëruese, sidomos për gratë e reja dhe fëmijët. Përpara largimit nga vendet e tyre dhe gjatë udhëtimit drejt vendit të destinacionit, punonjësit migrantë gëzojnë të drejtat vijuese:

- **Informimi**²³

²⁰ C097 – Konventa (Nr.97) për Migracionin për Motive Punësimi (e rishikuar), 1949. R086 – Rekomandimi Nr. 86 për Migracionin për Motive Punësimi (i rishikuar), 1949

²¹ R100 – Rekomandimi Nr. 100 për Mbrojtjen e Punonjësve Migrantë (vendet e pazhvilluara), 1955

²² C143 – Konventa Nr. 143 për Punonjësit Migrantë (Dispozita shtesë), 1975, R151 – Rekomandimi për Punonjësit Migrantë, 1975.

²³ R. 86, paragrafi 5(2). Konventa Nr.97, Shtojca I, Neni 5 dhe Shtojca II, Neni 6. Shih edhe Rekomandimin 86, Konventa Nr. 97, Neni 2.

Përpara largimit jashtë vendit, punonjësit migrantë kanë të drejtën të informohen mbi kushtet e përgjithshme të punës dhe jetesës në vendin ku kanë për qëllim të punojnë, si dhe për çështje të tjera që mund t'ju interesojnë si migrantë. Informacioni i dhënë duhet të jetë në gjuhën ose dialektin e tyre apo, së paku, në një gjuhë që e kuptojnë. Informacioni duhet ofruara falas. Duhet marrë masa kundër reklamave keqinformuese lidhur me migrimin dhe emigrimin. Gratë dhe të rinjtë, sidomos nga zonat rurale, janë shpesh më pak të informuar rreth kostove, rreziqeve dhe përfitimeve të migrimit, për shkak të qasjes së kufizuar në burimet e informimit, normave më të ulëta të shkrim-leximit etj. Kjo mund të çojë lehtësisht në situata shfrytëzuese. Për rrjedhojë, duhet kushtuar një vëmendje e veçantë që ky informacion të mbërrijë tek ata.

- **Rekrutimi²⁴**

Rekrutimi i punonjësve migrantë duhet kryer vetëm nga:

- autoritetet publike
- punonjësit e ardhshëm
- agjencitë e licencuara private.

Shërbimet e marrjes në punë që ofrohen nga institucioni publik i punësimit duhet të jenë falas. Punonjësit ose agjencitë private të përfshira në punësim duhet të marrin autorizim paraprak nga organi përkatës shtetëror dhe aktivitetet e tyre duhen kryer nën mbikëqyrje zyrtare, me qëllim që migrantët të jenë të mbrojtur nga forma të ndryshme të mundshme shfrytëzimi, si:

- tarifat e tepruara
- kontratat mashtruese
- përdorimi i propagandës mashtruese
- përpjekjet për shmangien e kontrolleve të emigracionit.

Autorizimi i agjencive private të punësimit kufizohet në kategori specifike punonjësish ose lloje specifike shërbimesh. Agjencitë private të punësimit vendosin tarifa punësimi për punonjësit vetëm në bazë të kushteve rigoroze.

Kur qeveritë mbajnë një sistem për mbikëqyrjen e kontratave të punësimit, punonjësit migrantë kanë të drejtën, përpara nisjes, të marrin një kontratë pune me shkrim, që mbulon kushtet e punës dhe kriteret e punësimit, veçanërisht normën e shpërblimit dhe kohëzgjatjen e kontratës. Qeveritë e vendit të origjinës dhe vendit pritës të migrantit mund të bien dakord që një kopje e kontratës t'i jepet punonjësit kur mbërrin në vendin pritës. Në këtë rast, punonjësi migrant duhet të marrë përpara nisjes një dokument i cili tregon të paktën kategorinë profesionale në të cilën do të angazhohet punonjësi migrant dhe kushtet e tjera të punës, veçanërisht paga minimale e garantuar.

²⁴ K. 97, Neni 7; K. 97, Shtojca I, Neni 4. K. 181, Neni 7. K. 97, Neni 7; K. 97, Shtojca I, Neni 4. K. 95, Neni 9, K. 97, Shtojca I, Neni 5 dhe Shtojca II, Neni 6. Shih edhe Rekomandimin Nr. 86

Kontrata ose çdo dokument që lidhet me punësimin duhet të jenë në një gjuhë që punonjësi migrant kupton. Nëse punonjësi migrant nuk mund të lexojë, atëherë, atij/asaj i duhet shpjeguar kontrata ose dokumentet.

✓ **Nisja e ndërmjetësuar²⁵**

Kur punonjësit migrantë largohen nga vendi i tyre, veçanërisht, për herë të parë, ata zakonisht kanë nevojë për ndihmë për t'u përballur me hapat praktike dhe administrative të përfshira. Ata duhet të marrin ndihmë nga autoritetet publike për t'u marrë me dokumentacionin dhe formalitete të tjera që lidhen me procesin e imigracionit. Këto shërbime duhen ofruar falas.

✓ **Kujdesi mjekësor²⁶**

Punonjësit migrantë dhe familjarët e tyre të autorizuar për t'i shoqëruar kanë të drejtë të përfitojnë ekzaminim dhe vëmendje mjekësore përpara nisjes. Punonjësit migrantë nuk duhet të detyrohen të kryejnë ekzaminime mjekësore me forcë apo që nuk janë konfidenciale, si analiza për shtatzëni dhe HIV/AIDS. Punonjësit migrantë nuk duhen skualifikuar apo pushuar nga puna për shkak se rezultatet e këtyre analizave janë pozitive.

✓ **Udhëtimi i lirë²⁷**

Punonjësit migrantë që janë punësuar ose angazhuar nga punëdhënësi nuk duhet të paguajnë koston e udhëtimit të tyre e as të familjeve të tyre, kur është rasti. Në praktikë, sidoqoftë, thuajse të gjithë punonjësve migrantë i'u duhet të mbulojnë shpenzimet e tyre të udhëtimit dhe organizimet e udhëtimit shpesh çojnë në praktika abuzive punësimi. Rekrutuesi ose punëdhënësi duhet të paguajë shpenzimet e udhëtimit.

✓ **Sigurimet shoqërore²⁸**

Sa i takon së drejtës së rimbursimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore, konventat e ONP-së parashikojnë bazën si dhe nxitin trajtimin e barabartë midis punonjësve migrantë dhe vendas në fushën e sigurimeve shoqërore.

7. Kuadri kombëtar ligjor, institucional dhe i politikave

Çështjet e migracionit janë trajtuar nga një sërë politikash dhe dokumentesh ligjore, të cilat analizohen në këtë seksion, për të dhënë një përmbledhje të saktë të të objektivave strategjike

²⁵ K. 97, Neni 2; K. 97, Shtojca I, Nenet 4 dhe 6, si dhe Shtojca II, Nenet 4 dhe 7.

²⁶ K. 97, Neni 5; Rekomandimi Nr. 86, paragrafët 12 dhe 14; Rekomandimi Nr. 100, paragrafi 8.

²⁷ Rekomandimi Nr. 100, paragrafi 7. Rekomandimi 86, Shtojca, Neni 12.

²⁸ ibid

të Shqipërisë në fushën e migracionit dhe rolin e njësive të vetëqeverisjes vendore për të kontribuar në arritjen e këtyre objektivave.

✓ **Kuadri kombëtar i politikave**

*Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian, 2022-2030*²⁹, parashikon një të ardhme ku Shqipëria trajton në mënyrë efektive sfidat dhe mundësitë e migracionit në përputhje me proceset globale të migracionit dhe objektivat e saj të integritit në BE. Deri në vitin 2030, strategjia synon një qeverisje të gjithanshme të migracionit, e përqendruar në menaxhimin e çështjeve dhe sfidave që lidhen me lëvizjet migratore. Objektivi i përgjithshëm është rritja e ndikimit pozitiv të migracionit në zhvillim, çfarë është në dobi si për migrantët, ashtu edhe për mbarë shoqërinë shqiptare.

Strategjia pranon se migracioni mbetet një faktor domethënës në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të Shqipërisë, ndërkohë që vendi shërben kryesisht si burim i migrantëve ekonomik. Emigrimi i individëve të kualifikuar dhe të arsimuar konsiderohet si i dëmshëm për përparimin socioekonomik të vendit, duke qenë se këta individë luajnë një rol thelbësor për nxitjen e zhvillimit. Për ta trajtuar këtë, strategjia e vendos theksin te promovimi dhe inkurajimi i migracionit të përkohshëm, sidomos i migracionit qarkullues të individëve të kualifikuar, si mjet për uljen e emigrimit të përhershëm. Më tej, nxitja e qeverisjes efektive të migracionit përmendet si përparësi kryesore e procesit të integritit të Shqipërisë në BE. Përveç kësaj, strategjia thekson rëndësinë e lehtësimit të migracionit dhe lëvizshmërisë së organizuar, të sigurt dhe të përgjegjshme. Këtu përfshihet zbatimi i politikave të mirëplanifikuara dhe të menaxhuara të migrimit, që mbrojnë të drejtat dhe mirëqenien e migrantëve. Duke u përqendruar në këto aspekte, strategjia synon ta pozicionojë Shqipërinë si një vend që e menaxhon efektivisht migracionin, maksimizon përfitimet e tij dhe garanton interesat e migrantëve dhe popullsisë vendase.

Në përputhje me objektivat e mësipërme strategjike, Strategjia Kombëtare për Migracionin, *2024-2030 dhe plani i saj i veprimit*³⁰ parashikon objektiva dhe masa më të detajuara që sigurojnë qeverisjen strategjike të migrimit. Menaxhimi i migrimit përmes përmirësimit të kuadrit ligjor dhe institucional, parandalimi i migrimit të parregullt nga Shqipëria dhe përmirësimi i mekanizmit të koordinimit për qeverisjen e migracionit janë disa prej objektivave kryesore të paraqitura në këtë dokument. Për t'i arritur këto objektiva, dokumenti politik përmban masa lidhur me rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të strukturave vendore të migracionit dhe diasporës. Masa të tjera kryesore shtesë parashikohen për të përmirësuar qeverisjen dhe menaxhimin e migracionit në

²⁹ VKM Nr. 88, datë 22.02.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian, 2022-2030";

³⁰ VKM Nr. 271, datë 02.05.2024, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin, 2024-2030, dhe Planit të saj të Veprimit, 2024-2026";

Shqipëri. Një masë thelbësore është shkëmbimi periodik i informacionit midis Sekretariatit Teknik të Migracionit dhe njësive vendore të migracionit dhe diasporës. Kjo siguron që si autoritetet qendrore, ashtu dhe ato vendore të jenë të mireinformuara dhe të koordinuara në përpjekjet e tyre.

Përveç kësaj, strategjia përfshin vendosjen materialeve informuese për pasojat e migrimit të parregullt dhe rrugëve për migrim të rregullt në njësitë administrative vendore. Kjo nismë edukuese synon të rritë ndërgjegjësimin e emigrantëve potencialë mbi rreziqet e migrimit të parregullt dhe përfitimet e zgjedhjes së kanaleve të rregullta migratore. Më tej, strategjia e migracionit bën thirrje për zhvillimin e dialogut politik dhe teknik midis njësive administrative vendor dhe strukturave të qeverisjes vendore për të zbatuar programet integruese me efektivitet. Ky dialog është thelbësor për të siguruar që politikat e migracionit janë kohezive të ekzekutuara mirë në nivelet e ndryshme të qeverisjes. Strategjia nxjerr gjithashtu në pah nevojën për trajnim me ndjeshmëri gjinore kushtuar migracionit për njësitë administrative vendore, për të trajtuar sfidat unike me të cilat përballen gjinitë e ndryshme në procesin e migrimit dhe për të siguruar që politikat dhe programet e migracionit të zbatohen në mënyrë përfshirëse dhe të barabartë.

Nga ana tjetër, objektivat e Strategjisë për Decentralizimin e Pushtetit Vendor³¹ përqendrohen te promovimi dhe forcimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor. Objektivat kryesore përfshijnë përmirësimin e cilësisë, të standardeve dhe të ofrimit të shërbimeve vendore. Këtu përfshihet rritja e kapaciteteve dhe efektiviteti i njësive vendore për të përmbushur nevojat banorëve të tyre me shërbime të cilësisë së lartë. Përveç kësaj, strategjia thekson zgjerimin e qeverisjes digjitale në nivel vendor. Duke përfshirë më shumë instrumente dhe platforma digjitale, njësitë vendore mund të ofrojnë shërbime dhe programe në mënyrë më transparente dhe efikase. Ky transformim digjital synon të ulë kostot, të rrisë qasjen dhe të përmirësojë aftësinë reaguese të administratave vendore në përgjithësi. Të gjitha bashkë, këto objektiva synojnë të krijojnë një kuadër më efektiv, gjithpërfshirës e progresiv të qeverisjes vendore, që mund t'i ushërbejë më mirë nevojave të të gjithë qytetarëve.

Në vitin 2018, Shqipëria miratoi *Paktin Global për Migracionin* (GCM)³² dhe, që prej asaj kohe parimet dhe objektivat e GCM-së janë integruar në politikat dhe kuadret e menaxhimit të migracionit të vendit. Përfshirja e tij ka forcuar qasjen e Shqipërisë ndaj qeverisjes së migracionit, duke theksuar migrimin e sigurt, të organizuar dhe të rregullt.

³¹ VKM Nr. 252, datë 20.04.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Pushtetin Vendor, 2023-2030, Planit të saj të Veprimit, 2023-2025 dhe pasaportës së treguesve”;

³² Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 19 dhjetor 2018, Pakti Global për Migracion të Sigurt, të Organizuar e të Rregullt (A/RES/73/195), gjendet në adresën <https://www.iom.int/resources/global-compact-safe-orderly-and-regular-migration/res/73/195>:

Në përpjekjet e saj për të harmonizuar strategjitë kombëtare me GCM-në, qeveria shqiptare ka përdorur mbështetjen dhe ndihmën e IOM-it për të harmonizuar Strategjinë aktuale Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit me GCM-në përmes ndihmës teknike, konsultimeve dhe nismave për ndërtimin e kapaciteteve, identifikimit të përparësive në nivel kombëtar, rajonal dhe global. Kjo ka çuar në miratimin e strategjive gjithpërfshirëse, që synojnë të rrisin mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, duke përmirësuar menaxhimin e të dhënave për migracionin dhe nxitjes së bashkëpunimit ndërkombëtar për të trajtuar me efektivitet sfidat e migrimit.

Si pjesë e veprimit në përputhje me GCM-në, institucionet shqiptare kanë vendosur një theks të konsiderueshëm mbi disa objektiva kryesore për përmirësimin e kuadrit të menaxhimit të migracionit. Këto PSV janë hartuar për të kontribuar te objektivi i rëndësishëm i ofrimit të informacionit të saktë dhe në kohë në të gjitha fazat e migracionit. Kjo garanton që emigrantët potencialë të jenë të mireinformuar rreth proceseve, kërkesave dhe mundësive që lidhen me migracionin, çka i'u jep mundësi të marrin vendime të sigurta. Shpërndarja e informacionit të besueshëm përmes kanaleve të ndryshme synon të mbështetë migrantët që të përballen me aspektet komplekse të migracionit me më shumë qartësi e siguri.

Më tej, vendi i është përkushtuar rritjes së qasjes në informacion dhe burime për të gjitha kategoritë e emigrantëve potencialë, duke u përqendruar posaçërisht te trajtimi dhe ulja e aspekteve të cënueshme në migracion, sidomos duke mbrojtur migrantët nga kushtet e padrejta të punës, shfrytëzimi, trafikimi dhe abuzimi. Ky angazhim përfshin zbatimin e masave të forta për të garantuar që të gjithë individët, sidomos ata që janë më të pambrojtur, të kenë qasje në një informacion të saktë dhe në mbështetjen e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e tyre gjatë rrugëtimit të migracionit. Përmirësimi i shpërndarjes së informacionit dhe shërbimeve mbështetëse ka si pikësynim të fuqizojë emigrantët potencialë me njohuritë dhe burimet e nevojshme për një përvojë migratore të sigurt dhe të informuar. Hartimi dhe miratimi i PSV-ve do të përmirësojë sistemin e migracionit, jo vetëm duke lehtësuar migrimin e ligjshëm dhe të sigurt, por edhe duka ruajtur dinjitetin dhe të drejtat e migrantëve.

Ka patur edhe zhvillime të tjera lidhur me Objektivin 18 të GCM-së, që përqendrohen tek investimi në zhvillimin e aftësive dhe njohjes së ndërsjellë të aftësive, kualifikimeve dhe kompetencave për të rritur aftësitë e migrantëve dhe për të lehtësuar integrimin e tyre. Që nga viti 2021, u krye procesi i përafrimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KShK) me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK). Nisma sigurohet që diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet arsimore shqiptare, që mbështeten te standardet e KShK-së, të kenë si referencë edhe nivelin përkatës të kualifikimeve të KEK-së. Procesi i referimit krijon lehtësi në njohjen e kualifikimeve shqiptare në vendet e BE-së³³, duke harmonizuar procesin e integritimit për

³³ Burimi i informacionit: Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe e Kualifikimeve, gjendet në adresën <https://www.akaftp.gov.al/korniza-shqiptare-e-kualifikimeve/>, vizituar më 25 qershor 2024;

emigrantët. Duke caktuar këto objektiva si përparësi, Shqipëria rikonfirmon angazhimin e saj ndaj GCM-së dhe objektivit të saj kryesor për krijimin e një mjedisi migracioni që është i sigurt, njerëzor dhe me përfitime të ndërsjella për të gjithë aktorët e përfshirë.

✓ **Kuadri vendor i politikave**

Shumë bashki kanë miratuar Planet Vendore për Migracionin dhe Diasporën, çka shënon një hap pozitiv drejt trajtimit të çështjeve të migracionit dhe diasporës. Bashkia e Tiranës ka dhënë shembullin me miratimin e përgjegjësive të reja të njësive të qeverisjes vendore për migracionin, duke miratuar Planin Vendor për Migracionin dhe Diasporën, 2022-2026³⁴. Ky plan synon të krijojë kushtet për një integrim të qëndrueshëm të migrantëve dhe emigrantëve të kthyer përmes përdorimit të sistemeve të informacionit dhe bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm. Po ashtu, edhe bashki të tjera, përfshirë Korçën³⁵, Shkodrën, Kukësin, Dibrën dhe Elbasanin, kanë hartuar planet e tyre vendor për migracionin dhe diasporën.

Megjithatë, këto plane vendore ishin formuluar dhe aprovuar përpara miratimit të strategjive aktuale për zhvillim, integrimin evropian dhe migracionin. Si rrjedhojë, ato nuk janë plotësisht të harmonizuara me vizionet dhe objektivat e paraqitura në këto dokumente të fundit strategjike. Kjo mungesë sinkronizimi paraqet sfida, pasi planet vendore nuk pasqyrojnë tërësisht kuadrin e gjithanshëm dhe të përditësuar kombëtar të hartuar për të trajtuar çështjet aktuale dhe mundësitë e migracionit.

Përveç kësaj, këto plane dëshmojnë një vëmendje të lavdërueshme tek riintegrimi i emigrantëve të kthyer dhe nxitja e ndërveprimit me diasporën, çfarë tregon angazhimin për t'i mbështetur me këto grupe efektivisht. Theksi tek riintegrimi pasqyron përpjekjet për të trajtuar nevojat e emigrantëve të kthyer dhe për të forcuar lidhjet me diasporën, të cilat janë aspekte thelbësore të menaxhimit të migracionit. Megjithatë, këto plane nuk arrijnë të parashikojnë dispozita të mjaftueshme për të ndihmuar shtetasit shqiptarë që duan të emigrojnë, çka është një hendek i konsiderueshëm në kuadrin vendor për menaxhimin e migracionit.

Miratimi i Procedurave Standarde të Veprimit për emigrimin për motive punësimi do ta trajtojë efektivisht këtë hendek, duke i orientuar bashkitë drejt ofrimit të mbështetjes së gjithanshme për emigrantët potencialë. Këtu përfshihet garantimi i qasjes në informacionin e saktë, në ndihmë juridike dhe burim të tjera që lehtësojnë vendime të informuara dhe të sigurta për migracionin. Miratimi i këtyre PSV-ve dhe trajtimi i kësaj mangësie bën që bashkitë të mund t'i harmonizojnë në mënyrë më efektive përpjekjet e tyre me objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare të migracionit. Ky hap është thelbësor për ndërtimin e një qasjeje kohezive dhe

³⁴ Gjetet në adresën https://tirana.al/uploads/2022/6/20220610110954_plani-vkb-nr20-date-642022.pdf;

³⁵ Gjetet në adresën <https://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/Planit%20Vendor%20te%20Veprimit%20per%20Migracionin%20dhe%20Diasporen%202022-2025.pdf>;

gjithpërfshirëse ndaj menaxhimit të migracionit që përmbush nevojat e larmishme të emigrantëve dhe përmirëson qeverisjen e përgjithshme të migracionit.

Një nga aspektet kryesore që theksohet në këto plane vendore është ngritja dhe forcimi i strukturave ose njësive të dedikuara, të cilat përqendrohen tek çështjet e migracionit dhe diasporës. Kjo vëmendje institucionale është kyçe për të garantuar një menaxhim sistematik e të qëndrueshëm të çështjeve të migracionit dhe të diasporës në nivel vendor. Megjithatë, këto plane nënvizojnë një hendek të konsiderueshëm që ekziston si rrjedhojë e mungesës së Procedurave Standarde të Veprimit për të trajtuar disa segmente të tjera të migracionit. Kjo mungesë nxjerr në pah nevojën për qasje më të gjithanshme dhe të strukturuar për t'i trajtuar të gjitha aspektet e migracionit në mënyrë efektive, duke rritur kështu efikasitetin e planeve vendore.

Miratimi i këtyre PSV-ve mund t'i nxisë bashkitë të përditësojnë planet e tyre vendore për migracionin, duke i sjellë ato në një linjë me strategjitë e reja kombëtare. Ky harmonizim do të garantojë një mbulim të gjithanshëm të të gjitha aspekteve të migracionit, përfshirë mbështetjen e fortë të emigracionit dhe zbatimin tërësor të PSV-ve. Ky integrim do të rrisë efikasitetin e menaxhimit të migrimit në nivel vendor, duke nxitur një qasje më kohezive e cila përmbush nevojat në ndryshim të migrantëve dhe harmonizohet me objektivat më të gjerë strategjike.

✓ **Kuadri ligjor kombëtar**

Detyrat dhe përgjegjësitë e njësive bashkiake për migracionin në kuadër të ligjit për vetëqeverisjen vendore

Gjatë viteve të fundit, vendi ynë ka qenë dëshmitar i ndryshimeve domethënëse në peizazhin e tij migrator, me shifra në rritje të shtetasve që kërkojnë mundësi jashtë vendit. Në përgjigje të këtyre prirjeve, Ligji për Vetëqeverisjen Vendore³⁶ është ndryshuar për t'iu ngarkuar bashkive përgjegjësi të reja sa i takon migracionit dhe diasporës. Sipas këtyre ndryshimeve, bashkitë janë ngarkuar me një sërë detyrash lidhur me migracionin dhe diasporën. Këto detyra janë thelbësore për të ruajtur lidhje të forta me diasporën, duke i'u ofruar migrantëve shërbimet e nevojshme dhe duke garantuar një administrim efikas në nivel vendor.

Një prej detyrave kryesore që i'u janë caktuar bashkive është ngritja e një strukture të posaçme për migracionin dhe diasporën. Qëllimi i kësaj njësie është të sigurojë që nevojat e emigrantëve të trajtohen në mënyrë të përshtatshme dhe efikase. Kjo njësi e dedikuar shërben si pikë qendrore kontakti për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me migrantët, përfshirë ata që emigrojnë për motive punësimi, duke siguruar që ata të marrin mbështetjen për të cilën kanë nevojë. Këtu përfshihet ofrimi i informacionit dhe referimeve për procesin e emigrimit përmes

³⁶ Ligji Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar me Ligjin Nr. 38/2019, datë 20.6.2019

sigurimit të orientimit dhe trajtimit të të gjitha shqetësimeve konkrete që mund të kenë emigrantët.

Bashkitë luajnë po ashtu rol thelbësor në orientimin e migrantëve nga diaspora nëpër procese të tilla si marrja e nënshtetësisë shqiptare dhe kuptimi i legjislacionit për investimet. Ata i'u ofrojnë migrantëve ndihmë dhe informacion, duke u siguruar që të jenë të mirë informuar rreth të drejtave dhe detyrimeve të tyre. Kjo mbështetje është thelbësore për t'i ndihmuar këta individë që të orientohen në sistemet ligjore e administrative shpesh komplekse, duke ua bërë më të lehtë ruajtjen e lidhjeve me Shqipërinë dhe duke përfutur nga mundësitë në vendin e tyre të origjinës.

Një tjetër përgjegjësi kryesore është koordinimi i përpjekjeve me ministritë përgjegjëse për punët e brendshme, punët e jashtme për të ofruar ndihmë dhe informacion të gjithëanshëm rreth çështjeve që lidhen diasporën dhe migracionin. Duke punuar ngushtë me këto ministri, bashkitë mund të ofrojnë mbështetje më efektive për migrantët dhe inkurajojnë investimet nga diaspora, duke nxitur kështu zhvillimin. Gjithashtu, ky koordinim siguron që migrantët të marrin informacion të njëtrajtshëm dhe të saktë, pavarësisht se cilit organ shtetëror i qasen për ndihmë.

Përveç këtyre roleve, bashkitë kanë përgjegjësi për të krijuar një mjedis mikpritës për emigrantët e kthyer. Këtu përfshihet edhe garancia që ata të kenë qasje në mundësi punësimi, shërbime sociale dhe burime të tjera, që mund t'i ndihmojnë të riintegrohen në komunitetin vendor. Duke ofruar këto shërbime, bashkitë luajnë rol kryesor për t'i ndihmuar emigrantët në procesin e tranzicionit dhe riintegrit.

Në përgjithësi, Ligji për Vetëqeverisjen Vendore thekson rolin e rëndësishëm të NjVV-ve në administrimin e çështjeve që lidhen me migracionin dhe diasporën. Duke përmbushur këto funksione, bashkitë kontribuojnë në mirëqenien e migrantëve, qoftë ata që largohen apo kthehen në Shqipëri, si dhe të pjesëtarëve të diasporës, nxisin zhvillimin e qëndrueshëm dhe forcojnë lidhjen midis Shqipërisë dhe komunitetit të saj në diasporë.

Duke u ofruar emigrantëve shërbime me cilësi të lartë, njësia vendore për migracionin dhe diasporën do të ndërtojë lidhje të forta me diasporën në të ardhmen. Kjo jo vetëm që do të krijojë një rrjet mbështetës për ata që jetojnë e punojnë jashtë vendit, por do të krijojë një vend të sigurt dhe të besueshëm për emigrantët ku të kthehen, në rast se zgjedhin ta bëjnë, duke garantuar një riintegrim pa pengesa në komunitetin e tyre të origjinës.

*Ligji për Emigrimin e Shtetasve Shqiptarë për Motive Punësimi*³⁷ rregullon procesin e emigrimit për shtetasit shqiptarë në kërkim të punësimit jashtë vendit. Ai synon të mbrojë të drejtat shoqërore dhe ekonomike të emigrantëve, të nxisë emigracionin e rregullt dhe të parandalojë emigracionin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

³⁷ Ligji Nr. 9668, datë 18.12.2006, "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi", i ndryshuar, gjendet në adresën <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2006/12/18/9668/f17925d0-49e2-478a-bfb2-3d4d2bac6ab5>;

Ligji përkufizon emigracionin e rregullt dhe të parregullt dhe kategoritë specifike të emigrantëve të punësuar, të vetëpunësuar, sezonalë dhe ndërkufitarë. Ai parashikon hartimin dhe zbatimin e politikave për të rritur kapacitetet administrative të Shqipërisë dhe për t'i sjellë në harmoni me legjislacionin dhe politikat e vendeve pritëse. Ligji garanton mundësi dhe trajtim të barabartë për të gjithë shtetasit shqiptarë që emigrojnë për motive punësimi, pavarësisht gjinisë, racës, besimit fetar apo prejardhjes shoqërore.

Autoritetet shtetërore e administrojnë procesin e emigracionit duke i'u ofruar emigrantëve dhe të atyre të cilët janë rikthyer, ndihmë juridike dhe administrative. Kjo përfshin informimin e vazhdueshëm të publikut rreth mundësive të punësimit dhe arsimit në vendet pritëse, si dhe çdo ndryshim ligjor përkatës që mund të ndikojë në kërkesat e punësimit në këto vende.

Autoriteti kryesor koordinues për zbatimin e ligjit është ministria përgjegjëse për punën, aktualisht Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe inovacionit. Autoritete të tjera shtetërore përgjegjëse për zbatimin e ligjit janë Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën e Punët e Jashtme. Ndryshimet e miratuara në vitin 2011 dëshmojnë një përpjekje të mëtejshme drejt zbatueshmërisë së ligjit, konkretisht përmes ngritjes dhe funksionimit të sporteleve për migracionin në zyrat vendore të AKPA-s, për t'i ndihmuar shtetasit shqiptarë që duan të emigrojnë, si dhe për të mbështetur riintegrimin e emigrantëve të kthyer. Ky ligj përcakton përgjegjësitë konkrete të ministrive të linjës sa i përket ofrimit të shërbimeve të caktuara në fushat e kujdesit shëndetësor, arsimit, punësimit ose sipërmarrjes, mbrojtjes sociale dhe strehimit për këtë kategori.

Ligji po ashtu parashikon detyrimin për t'u regjistruar në "Regjistrin e emigrantëve" të individëve që kërkojnë përfitime në kuadër të këtij ligji. Statusi i emigrantit merret duke paraqitur tek institucionet përkatëse një kontratë punësimi ose dokumentacion mbështetës që vërteton vetëpunësimin në vendin e origjinës ose dokumentin që vërteton se personi është familjar i një emigranti të punësuar ose të vetëpunësuar. Agjencitë private të punësimit duhet t'i raportojnë periodikisht ministrisë përgjegjëse mbi shtetasit shqiptarë që kanë ndihmuar për të gjetur punësim. Përgjegjësia e mbajtjes së regjistrit i'u transferua Agjencisë Kombëtare të Punësimit, tanimë e reformuar si Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi.

Ligji njeh rolin e veçantë të agjencive të punësimit, si dhe të aktorëve të tjerë jopublikë, vendas dhe të huaj, si partnerët socialë dhe organizatat jofitimprurëse, me synimin për t'i angazhuar në fushën e emigracionit të rregullt përmes rritjes së bashkëpunimit me to. Po ashtu, kjo konfirmon qasjen mbështetëse të qeverisë ndaj agjencive private të punësimit duke i përfshirë ato në shërbime si informimi, këshillimi dhe vlerësimi i kërkesave për punësim jashtë vendit, kryerjen e kërkimeve për punë, ofrimin e shërbimeve ndërmjetësuese, trajnimin e punëkërkuesve dhe duke i'u kërkuar agjencive të shkëmbejnë informacione me autoritetet shtetërore përgjegjëse për regjistrimin e emigrantëve.

Kur agjencia ndërmjetëson punësimin e shtetasve shqiptarë, ajo është përgjegjëse për

monitorimin e pajtueshmërisë me kriteret e kontratës dhe për të garantuar respektimin e të drejtave të emigrantëve. Në rast shkeljesh, agjencisë i kërkohet të njoftojë autoritetet shtetërore përgjegjëse, nëse marrin dijeni të ndonjë shkeljeje. Megjithatë, ligji nuk parashikon ose nuk specifikon instrumente për mënyrën se si agjencitë në Shqipëri mund të monitorojnë kontratat e ekzekutuara jashtë vendit.

Autoritetet shtetërore përgjegjëse dhe agjencitë private të punësimit duhet të publikojnë ofertat nga vendet pritëse, përfshirë mundësitë për punësim, trajnim profesional përmes punës dhe punësimin sezonal dhe ndërkufitar. Përveç kësaj, ligji i'u ngarkon autoriteteve publike përgjegjësinë e ofrimit të kurseve orientuese falas për emigrantët e regjistruar dhe familjet e tyre të regjistruara në regjistrin e emigrantëve, përfshirë aftësitë gjuhësore dhe njohuritë bazë për punësimin që kërkohen nga vendi pritës.

Vendimi i Këshillit të Ministrave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencive Private të Punësimit³⁸ përcakton një kuadër gjithëpërfshirës veprimi për agjencitë private të punësimit në Shqipëri, duke theksuar veçanërisht rolin dhe përgjegjësitë e tyre në ndërmjetësimin e mundësive të punësimit për shtetasit shqiptarë jashtë vendit. Ky vendim rendit udhëzime dhe përgjegjësi të qarta që synojnë të garantojnë praktika punësimi të drejta, transparente dhe të sigurta.

Një aspekt i rëndësishëm i vendimit është kërkesa që agjencitë private të punësimit të zbatojnë të gjitha marrëveshjet dypalëshe të lidhura midis qeverisë shqiptare dhe vendeve të huaja përkatëse. Kjo dispozitë siguron që agjencitë të veprojnë në përputhje me kuadret ligjore të hartuara përmes këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare, duke promovuar kështu mundësi të ligjshme dhe të rregulluara punësimi për shtetasit shqiptarë jashtë vendit. Kjo është në përputhje me strategjitë kombëtare për migracionin e punës dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, të cilat rrisin mbrojtjen dhe mbështetjen për punonjësit shqiptarë në tregjet e huaja të punës.

Një prej përgjegjësisve kryesore të përcaktuara në këtë vendim është se shërbimet e ofruara nga agjencia për punëkërkuesit duhet të jenë falas. Agjencia ndalohej të vendosë detyrime financiare, drejtpërdrejtëse tërthorazi, për punëkërkuesit, me përjashtim të shpenzimeve të nevojshme që duhen për të plotësuar dosjen e tyre administrative. Kjo dispozitë i mbron punëkërkuesit nga shfrytëzimi dhe sigurohet që pengesat financiare të mos vonojnë apo ndalojnë qasjen e tyre në mundësitë e punësimit. Më tej, kostot shoqëruese të shërbimeve ndërmjetësuese të ofruara nga agjencia mbulohen nga punëdhënësi, jo nga punëkërkuesi, duke garantuar më tej interesat e atyre që janë në kërkim të punësimit.

Vendimi nënvizon po ashtu parimin e trajtimit të barabartë të të gjithë punëkërkuesve, duke u siguruar që agjencitë të ofrojnë shërbime të paanshme dhe të drejta për të gjithë. Kjo është me rëndësi për të promovuar një treg pune gjithëpërfshirës, ku të gjithë individët, pavarësisht profilit

³⁸ VKM Nr. 101, datë 23.02.20218, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të agjencive private të punësimit";

të tyre, kanë mundësi të barabarta për të siguruar punë.

Një tjetër përgjegjësi e rëndësishme e agjencive private të punësimit është të informojnë punëkërkuuesit rreth kushteve të punës dhe të punësimit, përpara se të nisin marrëdhënien e punës. Kjo transparencë është jetike për të siguruar që punëkërkuuesit të jenë plotësisht të vetëdijshëm për atë çka i pret dhe të mund të marrin vendime të informuara mbi punësimin. Po ashtu, ndalohet që agjencitë të ndërmjetësojnë për punëkërkuuesit në vende pune që paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e tyre ose ku mund të jenë objekt abuzimi apo trajtimi diskriminues. Kjo dispozitë thekson rolin e agjencive në mbrojtjen, sigurinë dhe të drejtat e punëkërkuësve, duke garantuar që ata të vendosen në mjedise pune të sigurt dhe të respektueshme.

Për më tepër, vendimi përcakton përpunimin konfidencial të të dhënave të punëkërkuësve nga agjencitë. Ato duhet t'i trajtojnë të dhënat personale me fshehtësi të plotë dhe t'i përdorin vetëm për qëllimet për të cilat janë dhënë. Shpërndarja e këtyre të dhënave është rreptësisht e ndaluar, përveçse nëse jepet pëlqimi nga ana e punëkërkuësit. Dispozita në fjalë është thelbësore për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të punëkërkuësve, duke ndërtuar besimin midis agjencive dhe atyre të cilëve i'u shërbejnë.

Po ashtu, agjencive i'u kërkohet t'i ruajnë të dhënat personale të punëkërkuësve vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimet e posaçme për të cilat janë grumbulluar të dhënat ose për aq kohë sa punëkërkuësi dëshiron të jetë në listën e kandidatëve potencialë. Kjo garanton që të dhënat personale të mos mbahen me afat të pacaktuar, duke ulur rrezikun e keqpërdorimit dhe duke zbatuar praktikën më të mirë në mbrojtjen e të dhënave.

Vendimi i Këshillit të Ministrave parashikon një kuadër të qëndrueshëm për veprimtarinë e agjencive private të punësimit, duke theksuar rolin e tyre në zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe, çka garanton dhënien e shërbimeve të drejta dhe falas për punëkërkuuesit, mbron të drejtat dhe sigurinë e tyre dhe ruan fshehtësinë e të dhënave të tyre personale. Këto dispozita së bashku rrisin integritetin dhe efikasitetin e agjencive private të punësimit, si aktor i rëndësishëm për ndërmjetësimin e mundësive të sigurt dhe të barabarta të punësimit për shtetasit shqiptarë jashtë vendit.

8. Struktura dhe përshkrimi i PSV-ve

- Struktura e PSV-ve

Çdo procedurë e përshkruar në PSV ka drejtimet e saj lidhur me sa më poshtë:



ÇFARË – duhet ndërmarë
KUR – është përgjegjës subjekti për të vepruar dhe për të marrë masa
KUSH – duhet t'i marrë masat
SI – duhen zbatuar masat

- Përshkrimi i procedurës së PSV-ve

PSV-ja përmban trePSV të veçanta:


PSV 1: Forcimi i komunikimit dhe i shpërndarjes së informacionit tek emigrantët potencialë;

PSV 2: Shërbime drejtpërdrejtëose nëpërmjet internetit për emigrantët potencialë

PSV 3: Mbledhja e të dhënave dhe rritja e kapaciteteve të Njësisë për Migracionin dhe Diasporën për një ofrim më të mirë të shërbimeve për emigrantët potencialë

TrePSV-të përmbajnë masa përmes të cilave përshkruhen procedurat paraqitur në figurën 2:

Figura 2: Paraqitja vizuale e PSV-ve



PSV 1 Ofrimi i informacionit në internet dhe komunikimi me emigrantët potencialë

Kjo PSV përshkruan hapat për mënyrën sesi Njësitë e Migracionit do t'i ofrojnë informacion publikut të gjerë të emigrantëve potencialë pa kontakt të drejtpërdrejtë. Ajo lejon që informacioni të mbërrijë te të gjithë personat të cilët kanë interes të emigrojnë për motive punësimi e të tjera dhe synon publikun e gjerë.

Masa 1: Ofrimi i informacionit në internet për emigrantët potencialë

Çfarë: Çdo individ që merr në konsideratë të udhëtojë jashtë për motive punësimi dhe të tjera, që ka nevojë për informacion, mund ta përfitojë atë në internet. Ai ofron një bazë të mirë për personat e interesuar për emigrimin për motive punësimi dhe të tjera për të marrë informacion elementar rreth proceseve të emigracionit dhe rreth punës së njësive bashkiake, me qëllim që të mund të kontaktojnë personalisht njësitë bashkiake, nëse është nevoja.

Kush: Njësia e vetëqeverisjes vendore në bashkëpunim me MEKI-n.

Si: Ofrimi i informacionit për emigrantët potencialë përmes krijimit të Kanaleve të Gjithanshme të Informimit. Krijimi i një platforme elektronike të centralizuar dhe një portali komunikimi për shërbimet e migracionit në faqen e internetit të bashkisë:

1. Përfshirja e informacionit rreth funksioneve të bashkisë në fushën e migracionit dhe diasporës dhe të dhënat e kontaktit.
2. Hartimi dhe konceptimi i informacionit të qartë mbi të mirat e migracionit të ligjshëm dhe rreziqet që shoqërojnë migrimin e parregullt. Faqja e internetit e bashkisë të lidhet me faqen e MEKI-t që i kushtohet rritjes së qasjes në informacion të shtetasve shqiptarë lidhur me mundësitë, kushtet e punësimit dhe strukturat përgjegjëse, më vëmendje të veçantë te gratë, të rinjtë dhe kategori të tjera në nevojë;

Informacioni i ofruar në internet duhet të përmbajë sa vijon:

- Si të mësojnë rreth mundësive të punësimit në vendet e mundshme të destinacionit;
- Cilat janë kriteret themelore të punësimit në sektorin e dëshiruar (arsimi, aftësitë, kualifikimet, eksperiencia, kapitali, tarifa e agjencisë, pasaportat dhe vizat etj.);
- Si të mësojnë se cilët agjentë punësimi janë të besueshëm dhe cilët jo;
- Rreziqet që lidhen me punësimin e jashtëligjshëm;
- Të drejtat, përfitimet e detyrimet e emigrantëve dhe si t'i ushtrojnë këto të drejta në vendin e destinacionit dhe

➤ *Cilët janë faktorët e tjerë që duhen marrë parasysh kur merret në konsideratë punësimi në një vend tjetër.*

3. Sigurimi i qasjes përmes platformave të mediave sociale, për të mbërritur tek një audiencë sa më e gjerë.
4. Hapja e një adresë të dedikuar të postës elektronike për pyetjet lidhur me migracionin e rregullt për motive punësimi, studimi ose bashkimi familjar.
5. Sigurimi që të gjitha strukturat bashkiake të jenë të informuara për ekzistencën dhe detyrat e njësisë për migracionin dhe diasporën.
6. Nxjerrja në pah e historive të suksesit dhe dëshmimeve nga migrantët e ndihmuar.
7. Organizimi i veprimtarive informuese dhe fushatave të ndërgjegjësimit duke përdorur median lokale, aktivitetet komunitare dhe partneritetin me biznesin për të rritur ndërgjegjësimin.

Kur: Informacioni në internet është i vlefshëm gjatë gjithë procesit të migrimit në çdo kohë.

Masa 2: Komunikimi përmes ofrimit të informacionit me anë të materialeve të printuara dhe fushatave

Çfarë: Çdo person që merr në konsideratë të emigrojë për motive punësimi dhe të tjera, i cili ka nevojë për informacion dhe nuk e di/nuk mundet të përdorë platformat në internet, mund ta marrë informacionin përmes materialeve të printuara ose fushatave. Kjo do të nxisë ndërgjegjësimin mbi proceset e migrimit, do të rritë qasjen në mundësitë arsimore dhe profesionale jashtë vendit dhe do të mbështetë vendimmarrjen e informuar të emigrantëve potencialë.

Kush: Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me AKPA-n dhe Ministrinë e Brendshme.

Si: Përmes zhvillimit dhe shpërndarjes së materialeve/broshurave informuese për të edukuar emigrantët potencialë mbi formimin profesional, kurset e gjuhës etj. Njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me MB-në, marrin pjesë në zhvillimin e fushatave kombëtare duke shpërndarë informacion dhe duke rritur ndërgjegjësimin mbi rrugët e rregullta të emigrimit dhe pasojat e migrimit të parregullt. Përmes shpërndarjes në nivel vendor, MB-ja nxori **Udhëzimet për migracionin e rregullt** në format të printuar.

Hapat:

1. Hartimi i broshurave gjithpërfshirëse që renditin procedurat e migracionit të rregullt.

2. Përfshirja e udhëzimeve hap pas hapi për skenarë të ndryshëm emigrimi, si punësimi, studimi dhe bashkimi familjar.
3. Sigurimi që broshurat janë të lehta për t'u kuptuar, të përdorin gjuhë miqësore dhe gjithashtu të jenë të vlefshme në gjuhët e pakicave.
4. Përfshirja e informacionit mbi mundësitë e formimit profesional, kurset e gjuhës dhe burime të tjera përkatëse.
5. Sigurimi që broshurat mund të konsultohen në faqen zyrtare të internetit të bashkisë dhe të shpërndahen përmes zyrave vendore dhe qendrave komunitare.
6. Bashkëpunimi me AKPA-n në përfitim të emigrantëve potencialë përmes:
 - shpërndarjes së broshurave të AKPA-s për kurset e formimit profesional, zhvillimin e aftësive dhe kurset e aftësimit gjuhësor që janë të synuara për emigrantët potencialë;
 - shpërndarja e përmbajtjes informuese të AKPA-s lidhur me mundësitë për migracionin e rregullt për motive punësimi dhe përditësimi i broshurave informuese dhe udhëzimeve lidhur me punësimin etik të agjencive private të punësimit;
7. Shpërndarja e **Udhëzimeve për migracionin e rregullt** të MB-së.

Kur: Informacioni i printuar është i vlefshëm përpara nisjes.

Masa 3: Informimi i emigrantëve potencialë për shërbimet e vlefshme përmes Njësive për Migracionin dhe Diasporën

Çfarë: Të gjithë migrantët potencialë do të njihen me shërbimet e ofruara nga njësitë për migracionin dhe diasporën. Kjo do të rritë përdorimin e njësive për migracionin dhe diasporën për ndihmë dhe mbështetje të specializuar, si dhe do të informojë komunitetet dhe aktorët, duke kontribuar për perceptime pozitive të migracionit.


Kush: Njësitë e qeverisjes vendore.

Si: Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit për të promovuar ekzistencën e njësive të migracionit dhe të shërbimeve të ofruara nga njësitë e migracionit dhe diasporës:

1. Të sigurohet që të gjitha strukturat bashkiake të jenë të vetëdijshme për ekzistencën dhe funksionet e njësisë për migracionin dhe diasporën.
2. Referimi i personave që marrin shërbime nga strukturat bashkiake dhe kanë shfaqur interes për të emigruar, si dhe i migrantëve të kthyer te njësia për migracionin.

3. Nxjerrja në pah e historive të suksesit dhe dëshmime nga migrantët e ndihmuar.
4. Organizimi i veprimtarive informuese dhe fushatave të ndërgjegjësimit duke shfrytëzuar median vendore, ngjarjet komunitare dhe partneritetet me biznesin për të rritur ndërgjegjësimin.
5. Trajtimi i koncepteve të gabuara dhe shqetësimeve të përhapura lidhur me migracionin.

Figura 3: Paraqitja vizuale e PSV 1



PSV 2 Shërbimet e drejtpërdrejta dhe në internet për emigrantët potencialë

PSV 2 përshkruan procedurat lidhur me ofrimin e informacionit drejtpërdrejtë, ofrimin e shërbimeve dhe referimet tek institucionet përkatëse që mund të sigurojnë informacione shtesë dhe mbështetje për emigrantët për motive pune dhe për motive të tjera (studime dhe bashkim familjar).

Masa 1: Kontakti i parë i drejtpërdrejtë dhe dhënia e orientimit fillestar për mundësitë e punësimit dhe mundësi të tjera në vendet e destinacionit
--

Çfarë: Kontakti i parë i drejtpërdrejtë me emigrantët potencialë dhe ofrimi i këshillimit të personalizuar për punën, mundësitë e arsimit jashtë vendit, bashkimin familjar dhe kriteret ligjore.

Kush: Profesionistët nga njësitet për migracionin dhe diasporën në bashkëpunim me AKPA-n.

Si: Kur emigrantët potencialë vijnë te njësitet e qeverisjes vendore në kërkim të informacionit dhe ndihmës, së pari, është e rëndësishme të merret miratimi me shkrim nga personi/personat për të siguruar përputhjen me standardet ligjore dhe etike. Në rastet e personave me aftësi të kufizuara, që nuk mund të vijnë në zyrat e NjQV-ve, të sigurohet një konsultim fillestar nëpërmjet telefonit.

1. Informimi i emigrantëve potencialë rreth përfitimeve të migracionit të rregullt dhe rreziqet që lidhen me migracionin e parregullt (Shtojca 3). Informacioni duhet të ofrohet në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë. Nëse personi i përket pakicës informacioni mund të sigurohet në gjuhën e tij amtare. Nëse një person ka aftësi të kufizuara, t'i sigurohet informacion përmes telefonit. Nëse personi ka dëmtime dëgjimi, t'i ofrohet ky informacion përmes një interpreti.
2. Shpjegimi për emigrantët potencialë i qëllimit dhe objektit të shërbimeve që mund të ofrohen përmes zyrave.
3. Dhënia e formularit të vlerësimit/regjistrimit dhe miratimit (sipas Shtojcës 2 të këtij dokumenti) që paraqet shërbimet dhe informacionin që do të mblidhet dhe do të përdoret, si dhe marrja e miratimit të nënshkruar të emigrantit përpara se të procedohet me vlerësimin fillestar.

Kur: Gjatë kontaktit të parë me personin përpara vlerësimit.

Masa 2: Vlerësimi i nevojave

Çfarë: Pas kontaktit të parë me personin, kryhet një vlerësim fillestar i nevojave nga profesionisti i njësisë së qeverisjes vendore. Qëllimi i këtij vlerësimi është kuptojë saktësisht nevojat emigrantëve për motive punësimi dhe motive të tjera. Dhënia e shërbimeve (informacioni, ndihma dhe referimet) në nivel individual kërkon kontakt personal të drejtpërdrejtë. Për rrjedhojë, ai ofrohet zakonisht nga “profesionistë të trajtimit të rastit” nga njësitet për migracionin dhe diasporën, të cilët kanë përgjegjësi të posaçme për të punuar me emigrantët potencialë për motive punësimi, përfshirë emigrantët në situatë të pambrojtur, për të vlerësuar nevojat e tyre, për të identifikuar objektivat dhe për të hartuar një plan ndihmës, për të organizuar realizimin e planit dhe për të monitoruar e ndjekur në vijimësi efikasitetin e planit. Qasja e trajtimit të rastit është modeli i ofrimit të ndihmës për të gjithë personat që vijnë në njësi, po veçanërisht emigrantët potencialë për motive punësimi me nevoja komplekse dhe të shumëfishta, të cilët mund të kenë nevojë për shërbime nga disa agjenci dhe organizata.

Trajtimi i çështjeve lejon bashkëpunimin midis aktorëve dhe është e dobishme për vlerësimin, planifikimin, zbatimin, koordinimin dhe monitorimin e nevojshëm për të përmbushur efektivisht nevojat e shumta individuale dhe për të promovuar rezultate pozitive.

Kush: Profesionistët nga njësitet për migracionin dhe diasporën në bashkëpunim me MEKI-n dhe MEPJ-në.

Si: Me qëllim që të kuptohen saktësisht nevojat e personit që ka kërkuar informacion dhe/ose shërbime, profesionisti i NjVV-së duhet:

1. Të kryejë një seancë fillestare konsultimi me emigrantin potencialë, mbështetur në PyetëSORIN për Vlerësimin e Nevojave (Shtojca 2);
2. Bazuar në përgjigjet e marra nga pyetëSORI, të mbledhë të dhëna shtesë rreth kualifikimeve të emigrantit, përvojës së punës dhe vendit të preferuar të destinacionit.
3. Të dokumentojë gjetjet e vlerësimit me anë të çeljes së një dosjeje për rastin dhe të hartojë një plan të personalizuar veprimi (Formulari i planit personal, Shtojca 2);

Kur: Menjëherë pas kontaktit fillestar dhe përpara ofrimit të shërbimeve për emigrantët potencialë për motive punësimi.

Lista e kontrollit për profesionistët që zhvillojnë seancën e konsultimit me emigrantët potencialë për motive punësimi:

Gjatë kontaktit të parë me një emigrant potencialë për motive punësimi:

- ✓ Krijon një mjedis mikpritës e të rehatshëm;
- ✓ I drejtohet me emër dhe me një formë përshëndetjeje të përshtatshme emigrantit potencial;
- ✓ Fillon vlerësimin kur emigranti i mundshëm është gati dhe i rehatuar;
- ✓ Tregon sa do të zgjatë vlerësimi;
- ✓ Informon rreth procesit dhe formatit të vlerësimit;
- ✓ Pyet nëse emigranti i mundshëm ka ndonjë çështje specifike që ai/ajo dëshiron ta trajtojë gjatë vlerësimit;
- ✓ Përdor pyetje me fund të hapur;
- ✓ Përdor gjuhë të thjeshtë dhe shmang terminologjinë e panjohur ose të paqartë me emigrantin potencial;
- ✓ Rendit pyetjet në mënyrë të tillë që të ndërtohet besim duke i drejtuar pyetjet më delikate më vonë gjatë procesit të intervistës;
- ✓ Dëgjo në mënyrë aktive dhe sigurohu që migranti të ketë kohën e mjaftueshme për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe të shprehët;
- ✓ Bëj pyetje sqaruese kur informacioni i paraqitur është i paqartë apo kërkon më shumë kontekst;
- ✓ Përmbledh përfundimet e vlerësimit ose sqaro informacionin;
- ✓ Ndaj informacionin rreth shërbimeve, edhe nëse shërbimet nuk janë në dispozicion.

Masa 3: Referimet dhe ndihma

Çfarë: Pas çeljes së dosjes së rastit dhe kryerjes së vlerësimit fillestar, në procesin e realizimit të planit të personalizuar, profesionisti nga njësitë e migracionit vendos nëse ,dhe llojin e referimeve që duhen dhe llojin e ndihmës që duhet ofruar. Kjo i referohet informacionit mbi mundësitë, rritjen e nivelit të aftësive të punonjësve në standarde më të larta që përputhen me punësimin e tyre që preferojnë jashtë vendit, referimit tek agjencitë e punësimit, ofrimit të shërbimeve në fushën sociale, të arsimit, dokumentacionet etj.

Kush: Profesionistët nga njësitë për migracionin dhe diasporën, në partneritet me MEPJ-në, AKPA-n dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale.

Si:

A. Informacion i shtjelluar mbi tregun e punës bazuar në kërkesën për punë jashtë vendit dhe ofertës së punës në vendin e origjinës (për të hartuar një listë aftësishë që do të promovohen për punësimin jashtë vendit dhe një listë aftësishë ku ka mangësi oferte për të ndaluar largimin e mëtejshëm të trurit).

1. Përpilimi i këtij informacioni përmes komenteve të marra nga konsultimet me agjencitë private të punësimit dhe kontributet që rrjedhin nga raportet e atasheve dhe ambasadave shqiptare jashtë vendit që merren rregullisht përmes MEPJ-së.
2. Ofrimi i këtij informacioni /diskutimi i mundësive të punësimit me migrantët potencialë për motive punësimi;

B. Në përputhje me nevojat e identifikuar nga Masa 2 dhe informacionet mbi tregun e punës që i janë paraqitur emigrantëve potencialë për motive punësimi, ndihmo migrantin potencialë duke e njohur me mundësitë që ofrohen nga AKPA për kurset e formimit profesional ose kurset e gjuhëve të huaja, si dhe programet e formimit që ofrohen nga ofruesit publikë dhe privatë, që synojnë të rrisin punësueshmërinë e tyre përmes riaftësimit dhe rritjes së aftësive. **Kjo ndihmë jepet drejtpërdrejtë, por i pajis emigrantët potencialë për të përdorur edhe shërbimet në internet. Më pas, referojini ata tek AKPA:**

1. Shpjegojini migrantit potencial se mund të regjistrohet në Portalin Kombëtar për Punësim dhe Aftësi në adresën <https://www.puna.gov.al/> dhe eksploron gamën e 100 kurseve afatshkurtra të formimit profesional, si dhe kurset për aftësitë digjitale në internet.
2. Kurset e formimit profesional i'u ofrohen falas individëve të papunë të regjistruar në Zyrat e Punës (me përjashtim të kurseve të gjuhëve të huaja). Këto kurse zgjatin zakonisht nga tre deri në gjashtë muaj, katër orë në ditë, pesë ditë të javës.

Procesi i regjistrimit në internet hap pas hapi për t'u regjistruar në kursin e formimit profesional përmes portalit e-Albania:

- ✓ Kyçuni si qytetar në portalin e-Albania;
- ✓ Zgjidhni shërbimin "Kërkesë për regjistrim për kursin e formimit profesional";
- ✓ Klikoni butonin "Kërkesë e re", për të krijuar një kërkesë të re apo për të gjurmuar një kërkesë të mëparshme përmes numrit gjurmues;
- ✓ Plotësoni të dhënat e formularit dhe dërgoni kërkesën;
- ✓ Qendra Publike e Formimit Profesional shqyrton kërkesën brenda 14 ditëve, ju njofton përmes postës elektronike nëse kërkesa juaj është pranuar ose refuzuar, së bashku me arsyetimin përkatës;
- ✓ Në rast se kërkesa pranohet, Qendra Publike e Formimit Profesional ju dërgon të dhënat për dokumentet e nevojshme, për të vazhduar regjistrimin;
- ✓ Dokumentet që i duhen dorëzuar Qendrës Publike për Formimin Profesional në momentin e regjistrimit janë:

a. Kopje e dokumentit të identitetit: karta e identitetit (ID/pasaportë/certifikatë personale);

b. Kopje e certifikatës/diplomës së shkollës ose certifikatës ose vërtetimit nga shkolla që keni përfunduar ciklin e arsimit të detyrueshëm ose të mesëm;

- Për një udhëzim vizual, ndiqni videon udhëzuese në adresën:

https://www.youtube.com/watch?v=fVTIh1_V1EM

C. Në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale, referojini emigrantët potencialë për motive punësimi te Agjencitë e licencuara Private të Punësimit që veprojnë në territor për ndihmë më të specializuar për të ndjekur punësimin jashtë vendit:

1. Rrini të përditësuar rreth aktivitetit dhe profilit të emigrimit të agjencive të licencuara private të punësimit që veprojnë në territorin e bashkisë/qarkut (merrni listën nga AKPA), përmes konsultimeve të rregullta me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale.

- Ofrojeni emigrantëve potencialë për motive punësimi adresën për te faqja unike e internetit e AKPA, rubrika “punësimi jashtë i punonjësve”, ku publikohen kriteret dhe procedurat e punësimit jashtë të punonjësve, në përputhje me legjislacionin dhe praktikat kombëtare dhe te lista e publikuar në portalin e AKPA-s për agjencitë e licencuara private të punësimit, për t’iu siguruar informacion të mjaftueshëm

personave që kanë nevojë për shërbimet e tyre. Kjo do t'iu japë mundësi emigrantëve potencialë për motive punësimi të konsultojnë informacionin në internet.

3. Krijoni bashkëpunim me agjencitë e regjistruara dhe të licencuara private të punësimi përmes një Memorandumi Bashkëpunimi, mes të tjerash, për të monitoruar dispozitat e kontratës, për shkëmbyer informacion mbi procedurat e punësimit në vende të caktuara dhe për të ndarë statistika mbi rastet që kanë marrë ndihmë;

4. Referojini emigrantët potencialë për motive punësimi tek agjencitë private, të specializuara për ndërmjetësimin e mundësive të punësimit në vendet e tyre të dëshiruara të destinacionit. Kjo garanton mbështetje dhe orientim të personalizuar, duke siguruar përputhjen e individëve me agjencitë e pajisura për të menaxhuar aspektet komplekse të gjetjes së vendit të punës dhe procedurave të emigracionit në tregje të caktuara ndërkombëtare;

5. Ndiqni në vijimësi emigrantët potencialë të referuar përmes komenteve të marra nga Agjencitë Private të Punësimit (rregulluar përmes Memorandumit të Mirëkuptimit).

Shënim i rëndësishëm për profesionistët e bashkisë që i'uofron shërbime emigrantëve potencialë:

Është me rëndësi të theksohet se, si përfaqësues i Njesisë për Migracionin dhe Diasporën në bashki, duhet të jeni të informuar rreth shërbimeve dhe kontakteve përkatëse vendore. Këtu përfshihet ruajtja e komunikimit të rregullt me zyrat dhe agjencisë e duhura për të lehtësuar ndërveprimin dhe për të shërbyer si ndërlidhës për migrantët potencialë.

Puna me migrantët vulnerabël

Në qasjen e cila ka në qendër klientin ose migrantin që përdoret për menaxhimin e rastit, modeli i menaxhimit të rastit përqendrohet te klienti, në këtë rast, te migranti në situatë vulnerabël. Ajo sigurohet që migrantët në situatë vulnerabël të jenë në qendër të vendimmarrjes për ndihmë. Po kështu, ajo promovon pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje dhe zgjedhjet që lidhen me qasjen në shërbimet e disponueshme.

Shënim i rëndësishëm për institucionet e qeverisjes qendrore

MEKI dhe MB-ja duke t'i kushtojnë vëmendje të posaçme mbikëqyrjes së punësimit dhe shpërndarjes së kategorive të punonjësve, sidomos atyre në situatë të pambrojtur, kundër praktikave të këqija dhe abuzimit, përfshirë punonjëset shtëpiake femra dhe punonjësit me kualifikim të ulët;

D. Ndhimjoni emigrantët potencialë për motive punësimi të familjarizohen me platformën elektronike të shërbimeve të portalit e-Albania dhe orientojini përmes procesit të regjistrimit, duke i'u mundësuar qasje në shërbimet publike në internet:

1. Informoni migrantët potencialë rreth nevojës për t'u regjistruar në portalin e-Albania për të marrë shërbime publike.
2. Theksoni se e-Albania shërben si pika e vetme e kontaktit për qasjen në një varg shërbimesh elektronike që ofrohen nga administrata publike, përfshirë arsimin, familjen, punën, shëndetësinë, statusin juridik dhe shërbimet konsullore në internet.
3. Në platformën e-Albania mund të hyhet në adresën www.e-albania.al dhe aty ofrohen udhëzime të qarta në shqipe për procedurat e regjistrimit dhe veprimet e nevojshme për të përfituar shërbime publike.

Kriteret e regjistrimit:

- ✓ Numri personal që gjendet në kartën e identitetit/pasaportë, të cilat duhet të jenë të vlefshme në momentin e regjistrimit. Afati i vlefshmërisë së kartës së identitetit/pasaportës
- ✓ Numri i telefonit për të marrë kodet e sigurisë
- ✓ Një adresë e postës elektronike për të marrë adresën e aktivizimit të llogarisë suaj në e-Albania
- ✓ Të dhëna të sakta personale (emri, mbiemri, atësia, emri i nënës dhe datëlindja) që përputhen me të dhënat e regjistrimit të gjendjes civile.

Procesi i regjistrimit hap pas hapi:

- Shfletoni adresën www.e-albania.al.
- Klikoni "Regjistrim/Regjistrohuni".
- Plotësoni të gjitha fushat në formularin e regjistrimit:
 - ✓ Shënoni numrin personal të identifikimit (që gjendet në kartën tuaj të identitetit ose në pasaportë)
 - ✓ Specifikoni afatin e vlefshmërisë së kartës/pasaportës
 - ✓ Krijoni dhe ruani në mënyrë të sigurt një fjalëkalim
 - ✓ Jepni adresën e postës elektronike
 - ✓ Jepni numrin e telefonit
 - ✓ Zgjidhni një pyetje sigurie dhe jepni përgjigjen për rikuperimin e fjalëkalimit

- ✓ Hidhni të dhënat e sakta personale që përputhen me të dhënat e regjistrit të gjendjes civile
- Shenjoni kutizën që tregon miratimin për përdorimin e të dhënave personale
- Klikoni “Regjistrohu”
- Ndiqni procesin e aktivizimit:
 - ✓ Merrni një adresë aktivizimi përmes postës elektronike.
 - ✓ Vendosni kodin katërshifror që ju dërgohet në telefonin tuaj celular.
 - ✓ Aktivizoni llogarinë tuaj duke shtypur adresën dhe duke vendosur kodin katërshifror.
 - ✓ Pas aktivizimit, hyni me numrin tuaj personal të identifikimit dhe fjalëkalimin për të marrë të gjitha shërbimet në çdo kohë.

Për një orientim vizual, shihni videon udhëzuese në adresën:

<https://www.youtube.com/watch?v=xF4rvSwYnKI>

Përdorimi i platformës e- Albania

Disa kategori në platformën e-Albania që ndihmojnë emigrantët potencialë përfshijnë gjendjen civile, shërbimet e punësimit dhe formimit profesional, shërbimet arsimore, shërbimet shëndetësore dhe shërbimet konsullore.

Për të gjithë emigrantët potencialë, pavarësisht motiveve të tyre të emigrimit, dokumentet e gjendjes civile janë pjesë e rëndësishme e përgatitjes së dokumentacionit për të emigruar. Duke qenë se regjistri i gjendjes civile shihet kryesisht në internet, përmes platformës e-Albania shpjegoni personalisht se cilat dokumente mund të merren elektronikisht. Disa prej shërbimeve mund t’i merrni në këtë rubrikë të platformës:

- ✓ Aplikim për certifikatë personale
- ✓ Deklarimi i adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë
- ✓ Certifikatë familjare
- ✓ Certifikata e lindjes
- ✓ Certifikatë martese
- ✓ Aplikim për bashkim familjar
- ✓ Aplikim për certifikatën e trungut familjar
- ✓ Aplikim për korrigjimin e emrit/mbiemrit si gabim material
- ✓ Aplikim për ndryshimin e emrit/mbiemrit në rast moskualifikimi
- ✓ Aplikim për regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë vendit
- ✓ Aplikim për regjistrimin e martesës jashtë vendit me një shtetas/e të huaj
- ✓ Aplikim për regjistrimin e martesës jashtë vendit midis dy shtetasve shqiptarë
- ✓ Aplikim për regjistrimin e certifikatës së lindjes

- ✓ Aplikim për regjistrimin e aktit të martesës

Udhëzimet hap pas hapi për marrjen e certifikatës personale (Vini re që hapat janë relativisht të njejta për të gjitha aplikimet e tjera në regjistrin e gjendjes civile).

- ✓ Hyni si “qytetar” në portalin e-Albania;
- ✓ Zgjidhni shërbimin, "Certifikatë personale (për përdorim brenda vendit/për përdorim nga autoritetet e huaja)";
- ✓ Klikoni butonin "Përdor";
- ✓ Zgjidhni llojin e certifikatës duke shkuar te "Certifikatë personale sipas të dhënave aktuale" ose "Certifikatë personale sipas regjistrimeve të mëparshme";
- ✓ Certifikata personale sipas të dhënave aktuale nxirret në kohë reale duke shtypur butonin “Shkarko dokumentin me vulë”.
- ✓ Nëse certifikata ju duhet në gjuhë të huaj, klikoni butonin në cepin lart në të djathtë, “Shfaq certifikatën në gjuhë të huaj”;
- ✓ Në rastin e certifikatës personale sipas regjistrimeve të mëparshme, duhet zgjedhur periudha “Përpara vitit 2010” ose “Pas vitit 2010”, në varësi të periudhës për të cilën ju duhet certifikata;

Për periudhën "Përpara vitit 2010", duhet plotësuar rubrika me të dhënat e nevojshme dhe, në fund, klikohet butoni “Dërgo”;

Pas dërgimit me sukses të aplikimit, ai shqyrtohet nga zyra përkatëse e gjendjes civile dhe juve ju dërgohet brenda 3 ditëve pune certifikata në llogarinë tuaj në portalin e-Albania, nën rubrikën, "Dokumentet e mia";

-Për periudhën "Pas vitit 2010", duhet të plotësoni datën për të cilën e kërkon certifikatën dhe duhet të klikoni butonin, “Shfaq certifikatën”. Certifikata personale sipas regjistrimeve të mëparshme do të nxirret menjëherë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile të vitit 2010. Për të shkarkuar certifikatën personale sipas regjistrimeve të mëparshme, klikoni butonin “Shkarko dokumentin me vulë”.

- Për "Aplikimin për anëtarët e familjes" në kolonën "Anëtarët e familjes", zgjidh anëtarin për të cilin do të nxirrni dokumentin, "Certifikatë personale sipas të dhënave aktuale" ose "Certifikatë personale sipas regjistrimeve të mëparshme", pas vitit 2010.

Ju mund ta gjeni certifikatën e gjeneruar me vulë elektronike në çdo kohë te rubrika “Dokumentet e mia” te hapësira juaj në portalin e-Albania.

E. Sigurimi i informacionit për emigrantët potencialë (për çdo lloj motivi) mbi profilin e migracionit të vendeve të BE-së dhe pozitën ligjore e mundësitë e tyre në BE dhe tjetërkund:

1. Siguroni për emigrantët potencialë një adresë që ofron të dhëna të gjithanshme, në mënyrë që të jenë të informuar lidhur me:

- Kushtet e nevojshme, kriteret që duhen plotësuar dhe hapat procedurore për kategoritë e ndryshme të emigrantëve.

Adresa mbulon një gamë profilesh përfshirë punonjësit e punësuar, punonjësit me kualifikim të lartë, të transferuarit midis kompanive (ICT), ofruesit ndërkombëtarë të shërbimeve, punonjësit sezonalë, punonjës të vetëpunësuar, anëtarët e familjes, studiuesit, studentët, kursantët dhe vullnetarët. Adresa shpjegon të drejtat dhe privilegjet që mund të gëzojnë emigrantët gjatë qëndrimit jashtë vendit në secilën prej këtyre kategorive, duke u siguruar që individët të jenë të mirinformuar rreth pozitës së tyre ligjore dhe mundësitë brenda BE-së. Adresa mund të gjendet në [Informacione rreth emigracionit – AKPA](#).

Përveç informacionit që ofrohet në këtë adresë, njësia për migracionin dhe diasporën mund të hartojë paketa informuese për vende të tjera brenda dhe jashtë BE-së ku duan të emigrojnë shqiptarët.

F. Sigurimi i informacionit për emigrantët potencialë (për të gjitha motivet) mbi lejet ndërkombëtare të drejtimit të automjetit që përdoren jashtë vendit

Një nga dokumentet themelore që i'u duhen emigrantëve potencialë është leja e drejtimit të automjetit. Leja ndërkombëtare për drejtimin e automjetit është i nevojshëm për të përdorur automjetin jashtë Republikës së Shqipërisë dhe duhet të shoqërohet gjithnjë nga leja kombëtare për drejtimin e automjetit.

Emigrantët potencialë mund të drejtojnë automjetin në të gjitha vendet që janë pjesë e Konventës së Vjenës për Qarkullimin Rrugor. Adresa mund të shihet në https://unece.org/fileadmin/DAM/trans/conventn/CP_Vienna_convention.pdf

Udhëzimi hap pas hapi për marrjen e lejes ndërkombëtare për drejtimin e automjetit

Emigranti i mundshëm i interesuar për marrjen e lejes ndërkombëtare për drejtimin e automjetit duhet të paraqiten në sportelet e shërbimit të Drejtorisë Rajonale dhe të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- ✓ Dokument i vlefshëm identifikimi
- ✓ Fotokopje e lejes së vlefshme kombëtare të drejtimit të automjetit
- ✓ Foto me ngjyra e përmasave 4 x 5 cm, me pamje ballore dhe sfond pa ngjyra
- ✓ Pagesën për tarifën e shërbimit për lejen ndërkombëtare të drejtimit të automjetit

Vlefshmëria e lejes ndërkombëtare të drejtimit të automjetit lidhet me afatin e vlefshmërisë së lejes aktuale kombëtare të drejtimit të automjetit dhe nuk është më e gjatë sesa tre vjet. Sidoqoftë, nëse në kohën e lëshimit, afati i mbetur i lejes kombëtare të drejtimit të automjetit është më pak sesa tre vjet, leja ndërkombëtare e drejtimit të automjetit do të ketë një afat vlefshmërie që përputhet me atë të lejes kombëtare të drejtimit të automjetit.

Leja ndërkombëtare e drejtimit të automjetit mund të merret brenda 10-15 minuta nga momenti i aplikimit në sportel. Leja ndërkombëtare e drejtimit të automjetit lëshohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pavarësisht vendbanimit të aplikuesit.

Përveç kësaj, Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për njohjen e ndërsjellë dhe konvertimin e lejeve të drejtimit të automjetit (që janë në fuqi) me shtetet anëtare të Konventës së Vjenës: **Italia, Gjermania, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova, Greqia, Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.**

Emigrantët potencialë që zotërojnë leje shqiptare të drejtimit të automjetit dhe kanë marrë leje qëndrimi në vendet me të cilat Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe, si Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Greqia, Italia, Gjermania, Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Kroacia mund të marrin një leje drejtimi të automjetit në vendet pritëse për të njëjtën kategori në të cilën është e vlefshme leja e tyre shqiptare e drejtimit të automjetit.

Emigranti potencial duhet të shkojë në zyrat e transportit të vendit pritës, duke paraqitur si fillim lejen shqiptare të drejtimit të automjetit dhe lejen përkatëse të qëndrimit nga vendi pritës. Ata duhet të kërkojnë konvertimin e lejes së tyre shqiptare të drejtimit të automjetit në lejen e drejtimit të automjetit të vendit pritës. Nëse autoritetet e huaja kërkojnë verifikimin elementeve të caktuara të lejes së drejtimit të automjetit, marrëveshjet dypalëshe njohin mundësinë e komunikimit zyrtar përmes postës elektronike midis drejtorive përkatëse të dy vendeve.

G. Dhënia e ndihmës për emigrantët potencialë për motive punësimi (për të gjitha motivet, sidomos për motive studimi) me informacione rreth vlerësimit të diplomës për përdorim jashtë vendit

1. Ndiemoni emigrantët potencialë të zbulojnë kërkesat specifike të vendit të destinacionit ku do të përdoret diploma:

- ✓ Merr diplomën origjinale, transkriptimet zyrtare ose të dhënat akademike, përshkrimin e kursit ose të programit mësimor dhe vërtetim të identitetit;
- ✓ Ndiq hapat e përshkruara në këtë PSV për përkthimin dhe noterizimin në gjuhën e synuar;

- ✓ Ndiq hapat e përshkruara në këtë PSV për marrjen e vulës apostile, nëse kërkohet nga agjencia e vlerësimit;
- ✓ Zgjidh një agjenci të njohur dhe të respektuar për vlerësimin e kredencialeve në vendin e destinacionit (p.sh., WES, NACES, ECE);
- ✓ Plotëso dhe dërgo aplikimin e dërguar nga agjencia e vlerësimit bashkë me dokumentacionin e nevojshëm dhe paguaj tarifën e vlerësimit. Ju lutem, vini re se disa agjenci mund të kërkojnë që dokumentet të dërgohen drejtpërdrejtë nga institucioni arsimor që i lëshon;
- ✓ Pas verifikimit të dokumentacionit, agjencia lëshon raportin e vlerësimit që zakonisht përfshin njëjësimin e certifikatës/diplomës së huaj me kriteret e sistemit arsimor të vendit të synuar, kualifikimet ose kreditet e njohura shtesë dhe vlerësimin dhe interpretimin e notave dhe të kualifikimeve.
- ✓ Pas marrjes së raportit të vlerësimit, emigranti i mundshëm mund ta përdorë raportin për t'u arsimuar më tej, për punësim ose marrjen e licencës profesionale në vendin pritës.

Udhëzimi hap pas hapi për të marrë pullën apostile:

- ✓ Shqyrto certifikatat arsimore, licencat profesionale dhe dokumente të tjera përkatëse dhe identifikoj dokumentet që kanë nevojë për përkthim, noterizim dhe certifikim.
- ✓ Udhëzoje migrantin për hapat vijuese të procesit të noterizimit dhe të marrë një pullë apostile për dokumentet që do të përdoren jashtë vendit:
- ✓ Autoriteti përgjegjës për lëshimin e pullës apostile është Ministria e Punëve të Jashtme, drejtoria konsullore;
- ✓ Nëse dokumenti lëshohet nga administrata vendore dhe institucionet në varësi, ai duhet të verifikohet/certifikohet nga institucioni mbikëqyrës ose qendror;
- ✓ Nëse dokumenti lëshohet nga një institucion privat, nënshkrimi i zyrtarit që ka lëshuar dokumentin duhet noterizuar;
- ✓ Dokumenti duhet të përkthehet në gjuhën zyrtare të vendit pritës dhe noterizohet.
- ✓ Nëse është e nevojshme, të sigurohet lista e përkthyesve zyrtarë të certifikuar sipas kombinimit të nevojshëm të gjuhëve, që mund të gjendet në adresën www.dreitesia.gov.al/perkthyesit/.
- ✓ Dokumenti original që do të paraqitet me vulë apostile dhe kopja e dokumentit identifikues, nëse kërkohet vërtetimi i identitetit, dërgohet në MEPJ me anë të shërbimit korrier vetëm përmes agentëve postarë, të kontraktuar nga MEPJ-ja, që përfshijnë postën shqiptare, TNT-në dhe AC-në;

- ✓ Tarifa për pullën apostile është 200 lek (aktualisht), përveç kosos së shërbimit për korrierin;
- ✓ MEPJ-ja e dërgon dokumentin me pullë apostile me të njëjtin shërbim postar brenda 2-4 ditëve pune;
- ✓ Shtetasi këshillohet të paraqitet tek agjenti postar për të tërhequr dokumentin e pajisur me pullë apostile.
- ✓ Emigrantët potencialë informohen që, në përputhje me marrëveshjet dypalëshe që ka nënshkruar Shqipëria, dokumentet që përdoren në vende si Hungaria, Republika Çeke, Rumania, Rusia, Sllovakia, Bullgaria dhe Kosova pranohen drejtpërdrejtëpa qenë nevoja të legalizohet ose të mbajë pullë apostile.

H. Familjarizimi i emigrantëve potencialë për të gjitha motivet me shërbimet konsullore në internet dhe mbrojtja që mund të përfitohet përmes këtyre shërbimeve

1. Kur procesi i tranzicionit është përmbyllur dhe migrantët potencialë janë vendosur në vendin e destinacionit, është e rëndësishme që ata të informohen rreth shërbimeve konsullore të disponueshme gjatë qëndrimit të tyre jashtë vendit. Këto shërbime mund të merren përmes mjeteve të mëposhtme:
 - ✓ **Portali e-Albania:** Nën rubrikën “Shërbime konsullore” migrantët mund të gjejnë informacione dhe të marrë shërbime.
 - ✓ **Lidhja e emigrantëve potencialë për motive punësimi me faqen e internetit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme:** Gjendet në adresën <https://punetejashtme.gov.al/sherbimet-konsullore-online/> Kjo faqe interneti ofron informacione për procedurat automatike dhe digjitalizimin e të gjitha shërbimeve konsullore. Duke shtypur mbi secilin prej shërbimeve konsullore të renditura, migrantët mund të gjejnë detaje lidhur me procedurat, dokumentet e nevojshme, afatet dhe kostot. Në fund të përshkrimit të çdo shërbimi konsullor gjendet butoni “Shtyp këtu”, që do t’i çojë migrantët potencialë në platformën e-Albania, ku mund të aplikojnë drejtpërdrejtëelektronikisht për shërbimet që kanë nevojë.

I. Dhënia e ndihmës për emigrantët për regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë Shqipërisë

1. Emigrantët që jetojnë jashtë vendit, të cilët duan të regjistrojnë fëmijët e tyre mund ta përfundojnë këtë procedurë në internet, përmes portalit e-Albania.

Udhëzimet hap pas hapi për regjistrimin e fëmijëve:

- ✓ Hyni në portalin e-Albania
- ✓ Zgjidhni shërbimin, "Aplikimi për regjistrimin e fëmijës"
- ✓ Klikoni butonin "Përdor"
- ✓ Zgjidhni nëse do të bëni një aplikim të ri ose do të gjurmoni statusin e një aplikimi ekzistues:

- Për të gjurmuar statusin e një aplikimi ekzistues, vendosni numrin e aplikimit dhe, më pas, klikoni butonin "Kërko"

-Për të filluar një aplikim të ri, plotësoni të dhënat personale në formularin elektronik dhe ngarkoni dokumentacionin në vijim:

- a) Akti i lindjes së fëmijës ose certifikata e lindjes së fëmijës, të lëshuara nga autoritetet e huaja, të pajisura me pullë apostile;
- b) Dokumentet e identitetit të prindërve (pasaporta ose karta shqiptare e identitetit)
- c) Përkthimi i aktit ose certifikatës së lindjes, i pajisur me pullë apostile (nëse përkthimi i certifikatës nuk është i pajisur me pullë apostile, përkthimi në shqipe duhet të kryhet në konsullatë. Nëse përkthimi kryhet nga një përkthyesi licencuar, duhet shoqëruar me një "certifikatë përkthimi", e cila lëshohet dhe nënshkruhet nga konsulli. Përkthimi ose tarifa e përkthimit të certifikatës është 10 euro faqja dhe mbulohet nga shtetasi që aplikon)
- d) Nëse një nga prindërit është shtetas i huaj, kërkohet një deklaratë e noterizuar e prindit të huaj që shpreh miratimin e regjistrimit të fëmijës në Shqipëri.

- ✓ Pas ngarkimit të dokumentacionit të nevojshëm, në adresën e postës elektronike që keni vendosur në aplikim, do t'ju dërgohet konfirmimi i aplikimit, si dhe kodi i posaçëm i aplikimit (që ju lejon të gjurmoni ecurinë e aplikimit në çdo kohë).
- ✓ Dërgoni dokumentin origjinal të aktit të lindjes së fëmijës ose certifikatën e lindjes së fëmijës në konsullatë, personalisht ose përmes shërbimit postar.
- ✓ Pas verifikimeve të nevojshme të kryera nga përfaqësuesit e Ambasadës/Konsullatës, do të njoftoheni me anë të postës elektronike ose përmes numrit të telefonit (në rast urgjence) lidhur me regjistrimin e fëmijës suaj.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit është brenda 10 ditëve dhe nëse ka parregullsi në dokumentacion, koha për marrjen e shërbimit gjatë maksimumi 30 ditë.

J. Informimi i emigrantëve potencialë (për të gjitha motivet) lidhur me përfitimet në kuadër të Marrëveshjeve Ndërkombëtare Dypalëshe për Mbrojtjen Sociale

Marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe për mbrojtjen sociale ndihmojnë migrantët që kanë punuar në Shqipëri dhe një vend tjetër me të cilin Republika e Shqipërisë ka një marrëveshje të

tillë. Këto marrëveshje synojnë të bashkërendojnë skemën shqiptare të sigurimeve shoqërore me skemën e sigurimeve të vendeve të tjera kontraktuese dhe shoqërohen nga marrëveshjet ose rregullat administrative dhe format e përshtatshme për t'i zbatuar në praktikë rregullat për të cilat është rënë dakord. Informacioni lidhur me marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe për mbrojtjen sociale, që përcakton me detaje marrëveshjet që Shqipëria ka nënshkruar me vende si Turqia, Belgjika, Hungaria, Luksemburgu, Maqedonia e Veriut, Republika Çeke, Gjermania, Austria, Kosova, Kanadaja, Zvicra dhe Kroacia mund të gjenden në adresën <https://www.iss.gov.al/?p=10093>. Kohët e fundit, Republika e Shqipërisë finalizoi marrëveshjen dypalëshe me Italinë në fushën e sigurimeve shoqërore³⁹ dhe një tjetër për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit, që u nënshkrua më 6 nëntor 2023 dhe hyri në fuqi më 25 mars 2024⁴⁰.

Në varësi të fushës së zbatimit, marrëveshjet dypalëshe mbulojnë përfitimet monetare (përfitime të ofruara nga skema e sigurimeve shoqërore) ose kujdesin shëndetësor (ofruar nga legjislacioni për sigurimet shëndetësore të vendeve që janë palë në marrëveshje). Këto marrëveshje të nënshkruara nga qeveria shqiptare në fushën e mbrojtjes sociale, që kanë kaluar procesin e ratifikimit, mbeten të vlefshme për një afat të pacaktuar.

Përfitimet nga Marrëveshjet Dypalëshe që i'u garantohen punonjësve migrantë:

- ✓ **Trajtim i barabartë:** Punonjësit migrantë kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime në kuadër të mbrojtjes sociale si shtetasit e vendit pritës, pa asnjë formë diskriminimi.
- ✓ **Përcaktimi i legjislacionit të zbatueshëm:** Marrëveshjet parashikojnë zbatimin e legjislacionit të vetëm një vendi. Përfitimet monetare, si pensionet e pleqërisë, pensionet e aftësisë së kufizuar duhen siguruar nga sistemet e pensionit të secilit vend ku është i siguruar migranti. Po kështu, kujdesi shëndetësor përfshihet në objektin e marrëveshjes, kostot e përfitimeve të kujdesit mjekësor duhen rimbursuar nga sistemi i sigurimit shëndetësor të vendit ku është siguruar migranti, edhe nëse i'u ofrohet në vendin e rezidencës.
- ✓ **Ruajtja e të drejtave:** Pa një marrëveshje midis shteteve, punonjësit migrantë rrezikojnë të mos i përmbushin kriteret minimale për të përfituar nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore, pavarësisht kontributeve të tyre në vendin pritës. Marrëveshjet dypalëshe parashikojnë bashkimin e periudhave të plotësuara të sigurimeve në të dyja vendet për të përmbushur kërkesat ligjore të të dyja skemave. Periudhat e plotësuara të sigurimit njihen edhe nga vendi tjetër, me kusht që të mos të jenë të mbivendosura. Marrëveshjet dypalëshe parashikojnë bashkimin e periudhave të plotësuara të sigurimeve në të dyja vendet, me qëllim që të përmbushen kushtet ligjore në të dyja

³⁹ <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/05/16/47/28ee41bf-d8ec-45af-8514-031a6476927e;q=Italise;>

⁴⁰ <https://qbz.gov.al/eli/njoftim/2024/03/27/4719/e658cba4-40b4-497b-9425-637c6a90a43f;q=Italise;>

skemat (shqiptare dhe të huaj). Periudhat e plotësuara të sigurimeve në një vend njihen edhe nga vendi tjetër, me kusht që të mos të jenë të mbivendosura. Çdo vend ofron përfitime deri në atë masë që migranti ka kontribuar në skemën e tij. (Për shembull, një migrant i cili ka emigruar për shumë vite dhe ka vetëm 10 vjet të siguruara në Shqipëri. Kur ai/ajo arrin moshën e pensionit, edhe pse ai/ajo nuk e ka plotësuar periudhën minimale për marrjen e pensionit të pleqërisë, nëse kombinohen 10 vjet të siguruara në Shqipëri me periudhën e plotësuar jashtë vendit, duke plotësuar 15 vitet e kërkuara nga legjislacioni shqiptar, ai/ajo ka të drejtë të përfitojë nga pensioni shqiptar në pensionin në vendin tjetër, nëse përmbush kushtet për t'i përfituar, që përcaktohen nga skema e sigurimeve e vendit në fjalë). Periudhat e sigurimeve të plotësuara në secilin vend konfirmohen nga institucioni kompetent i sigurimeve shoqërore, përmes një formulari specifik të quajtur, "Verifikimi i periudhës së siguruar"

- ✓ **Transferimi i përfitimeve:** Marrëveshjet dypalëshe garantojnë të drejtën e individit për të marrë pagesat e caktuara të përfitimeve kudo të qëndrojnë. Për shembull, nëse një person jeton jashtë vendit, pensioni shqiptar transferohet në llogarinë e tyre bankare në vendin e huaj pa kosto transferimi dhe anasjelltas. Marrëveshjet parashikojnë vetëm eksportin e përfitimeve, jo eksportin e kontributeve që paguhet në skemën shqiptare ose anasjelltas.
- ✓ **Ndihma administrative:** Migranti mund të aplikojë për përfitime në skemat e të dyja vendeve njëkohësisht tek agjencia përkatëse më e afërt, qofshin këto zyrtarë të sigurimeve shoqërore të shteti ku kanë qëndrimin, në vendin e huaj ose në Shqipëri. Kjo siguron që ata të mos penalizohen apo të mos humbasin afatet ligjore, për shkak të distancës së largët në procesin e aplikimit.

Kërkesat për përfitime nga skemat e të dyja shteteve duhen plotësuar duke përdorur formularët përkatës dygjuhësh, "Kërkesë për pension". Dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e këtyre përfitimeve në një vend tjetër nuk duhet përkthyer, noterizuar apo pajisur me vulë apostile.

Për shtetasit që jetojnë në Shqipëri, të cilët duan të aplikojnë për një pension të huaj, formularët e aplikimit mund të gjenden në rubrikën, "Formularë aplikimi". Këta formularë mund të shkarkohen, të plotësohen dhe të dërgohen me postë në adresën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, "Rruga e Durrësit nr. 83, Tiranë". Kjo siguron që kërkesa t'i dërgohet institucionit homolog, që përpunon pensionin e huaj.


Duke qenë se mosha e pensionit ndryshon nga vendi në vend, nëse e drejta për pension në Shqipëri lind më herët në kohë, shtetasi mund të aplikojë drejtpërdrejtë në platformën e-Albania. Nëse nuk plotëson kriterin minimal ligjor prej 15 vitesh kontribute, ai duhet të deklarojë në formularin e aplikimit për pension në internet, në rubrikën e shënimeve, nëse ka periudha

sigurimi jashtë vendit. Kjo deklaratë siguron që shtetasve të mos i'u mohohet e drejta për të përfituar.

Ky informacion i lejon strukturat e sigurimeve shoqërore të bashkërendohen me njëra-tjetrën për të gjurmuar periudhat nga vendi i huaj me të cilin Shqipëria ka marrëveshje.

Kur: Të gjitha këto shërbime ndihme dhe referime kryhen pasi është përfunduar vlerësimi fillestar dhe mund të zbatohen përgjatë gjithë procesit të migrimit/mbërritjes së emigrantëve në vendin e destinacionit.

Figura 4: Paraqitja vizuale e PSV 2



PSV 3 Mbledhja e të dhënave dhe rritja e kapaciteteve të Njësive për Migracionin dhe Diasporës për ofrimin më të mirë të shërbimeve për emigrantët potencialë

Kjo PSV përshkruan procedurat për përmirësimin e efikasitetit të njësive për migracionin dhe diasporën, në të shërbim të emigrantëve potencialë, si dhe procedurave për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave.

Masa 1: Vlerësimi dhe trajtimi i nevojave për rritjen e kapaciteteve të Njësive për Migracionin dhe Diasporën

Çfarë: Rritja e kapaciteteve të profesionistëve të njësive për migracionin dhe diasporën është parakusht ofrimin efektiv dhe efikas të ndihmës dhe shërbimeve profesionale për emigrantët potencialë.

Kush: Bashkia në bashkëpunim me MB-në.

Si: Procesi i vlerësimit të nevojave lidhur me rritjen e kapaciteteve kryhet me anë të një analize skrupuloze shumëplanëshe të njohurive dhe kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore, në bashkëpunim me MB-në:

1. Identifikimi i mangësive në burime, personel dhe infrastrukturë përmes intervistimit të profesionistëve që punojnë në njësi, si dhe me anë të inspektimeve të kapaciteteve infrastrukturore në raport me numrin e pritshëm të emigrantëve potencialë në vit nëpër bashki dhe dorëzimi i vlerësimit të nevojave për rritjen e kapaciteteve institucionale në MB.
2. Hartimi i planeve strategjike në bashkëpunim me MB-në për rritjen e detyrueshme dhe sistematike të kapaciteteve dhe shpërndarjen e burimeve.
3. Zbatimi, në bashkëpunim me MB-në, i ushtrimeve për rritjen e kapaciteteve që synojnë edhe punën me grupet e migrantëve në situata vulnerabël dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Kur: Çdo vit.

Masa 2: Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe vendore

Çfarë: Për të rritur bashkëpunimin rajonal dhe ndërkufitar dhe për të mbështetur rrjetin e migrantëve, bashkitë institucionalizojnë bashkëpunimin me MEPJ-në, MB-në MEKI-n, AKPA-n dhe bashkitë e tjera.

Kush: Bashkitë, MEKI, MB-ja, MEPJ-ja, AKPA dhe bashkitë e tjera

Si: Institucionalizimi i bashkëpunimit me institucionet e qeverisjes qendrore dhe forcimi i partneriteteve me bashkitë fqinjë dhe zyrat e AKPA-s për të shkëmbyer informacion dhe praktikat më të mira.

1. Ndarja e praktikave më të mira dhe burimeve përmes mbledhjeve sistematike dhe projekteve të përbashkëta.
2. Koordinim me Zyrat vendore të AKPA-s për mbështetje dhe bashkëpunim.
3. Bashkëpunim me MEKI-n për nisma rajonale për trajtimin e sfidave të përbashkëta të migracionit:
 - Sigurimi i informacionit për MEKI-n me qëllim përgatitjen e studimeve të vlerësimit për të përcaktuar nevojën për marrëveshje dypalëshe punësimi, rregullimin e migracionit të rregullt të shtetasve shqiptarë për motive punësimi;
 - Sigurimi i informacionit për MEKI-n mbi përparësitë e identifikuara të vendeve për të lidhur marrëveshje dypalëshe për migracionin për motive punësimi dhe përmirësimin e njohjes së shërbimeve sociale, bazuar në të dhënat e mbledhura nga ofrimi i shërbimeve për emigrantët potencialë për motive punësimi.
 - Sigurimi i informacionit për MEKI-n lidhur me nevojën e përmirësimeve ligjore për migracionin e punës dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit në dobi të migrantëve, në përputhje me standardet ndërkombëtare.
4. Bashkëpunim me MB-në për rritjen e kapaciteteve profesionale në njësitë për migracionin dhe diasporën dhe për mbledhjen e të dhënave (shtjelluar në Masën 3).
5. Marrja, së bashku me MEPJ-në, e të dhënave të përditësuara mbi shërbimet konsullore dhe pjesëmarrja në projektet rajonale dhe ndërkufitare për të përmirësuar situatën e migracionit të punës.

Kur: Vazhdimisht.

Masa 3: Menaxhimi dhe raportimi i të dhënave

Çfarë: Mbledhja dhe mbajtja e të dhënave të sakta për prirjet e migracionit dhe përdorimit të shërbimeve, si dhe përditësimi i informacionit rreth kushteve të punësimit në vendet e destinacionit. Ky informacion do t'i ndihmojë bashkitë të kuptojnë më mirë objektin e nevojave të emigrantëve potencialë.


Kush: Specialistët e njësive për migracionin dhe diasporën, në bashkëpunim me MB-në dhe AKPA-n.

Si:

1. Hartimi i procedurave për marrjen dhe dhënien e përditësimeve periodike mbi kushtet e punësimit në vendet e zakonshme të destinacionit për punësim, si Italia, Greqia dhe Gjermania. Kjo duhet të ndjekë shembullin e mirë të dhënë nga AKPA, në adresën [Informacione rreth emigracionit – AKPA](#).
2. Hartimi i procedurave për marrjen e përditësimeve periodike mbi Erasmus-in ose programe të ngjashme studimi.
3. Përfshirja e migrantëve të kthyer në proces për të përditësuar informacionin rreth kushteve të punësimit në vendet e destinacionit, bazuar në përvojat e tyre.
4. Ndjekja e metodikës së bashkërenduar për mbledhjen e të dhënave, e hartuar nga MB-ja, në përputhje me planin e statistikave dhe mbledhja, më pas, e të dhënave të zbërthyera sipas gjinisë, moshës, statusit dhe karakteristikave të tjera të migrantëve dhe dërgimi i raporteve periodike në Sekretariatin Teknik të Migracionit.

Kur: Gjatë gjithë procesit të punës me emigrantët dhe emigrantët potencialë.

Figura 5: Paraqitja vizuale e PSV 3



Shtojca 1: Formulari i vlerësimit

BASHKIA _____

Data:									Emri i plotë i zyrtarit të bashkisë:
-------	--	--	--	--	--	--	--	--	--------------------------------------

Emri i plotë i shtetasit*: _____

(*Të dhënat vullnetare dhe vetëm pas nënshkrimit të deklaratës për mbrojtjen e të dhënave personale)

Gjinia:	☐ M ☐ F
---------	---

Mosha: ☐ <20 ☐ 20-25 ☐ 26-30 ☐ 31-40 ☐ 41-50 ☐ 51-60 ☐ >61

Kombësia:

Qyteti/Fshati:

Profesioni:

Statusi aktual i punësimit: ☐ I/e punësuar ☐ I/e vetëpunësuar ☐ Student ☐ I/e papunë ☐ Në pension

Niveli më i lartë i arsimit: ☐ Asnjë arsim formal ☐ Elementar ☐ I mesëm ☐ Arsim profesional
☐ Formim profesional ☐ Bachelor ☐ Master ☐ Doktoraturë ☐

Diplomë tjetër universitare

Njohuri të gjuhës angleze: ☐ Jo ☐ Fillestar ☐ Nivel mesatar ☐ Nivel i përparuar ☐ Nivel amtar

Njohuri të një gjuhe tjetër (_____) ☐ Jo ☐ Fillestar ☐ Nivel mesatar ☐ Nivel i përparuar ☐ Nivel amtar

Keni jetuar më parë jashtë vendit për më shumë se 3 muaj? ☐ PO ☐ JO

Të dhëna shtesë (vendi dhe arsyeja e qëndrimit):

Motivi aktual për udhëtimin tuaj jashtë vendit: ☐ Punësim ☐ Studim/formim ☐ Bashkim familjar ☐ Azil ☐ Tjetër

Shpjegoni:

Kohëzgjatja e synuar e qëndrimit jashtë vendit: ☐ 0 – 3 muaj; ☐ 03-12 muaj; ☐ 1-5 vjet ☐ 6-10 vjet ☐ >10 vjet

Vendi i synuar i destinacionit?

A po merrni aktualisht shërbime nga ndonjë agjenci punësimi në Shqipëri apo një vend tjetër? ☐ PO ☐ JO

Të dhëna shtesë (emri dhe vendndodhja e agjencisë)

Keni paguar ndonjë tarifë apo shpenzime të tjera për shërbimet e ofruara nga agjencia e punësimit?

☐ PO ☐ JO

Të dhëna shtesë

Keni marrë këshillim ose mbështetje të një lloji tjetër nga ndonjë agjenci/organizatë në vendin pritës? ☐ PO ☐ JO

Keni një kontratë punësimi në fazë bisedimesh apo të finalizuar në vendin pritës? ☐ PO ☐ JO

Të dhëna shtesë _____

Keni marrë shërbime nga ndonjë organizatë tjetër në Shqipëri?

☐ PO ☐ JO

Nëse PO, ju lutemi shpjegoni më poshtë:

Nëse PO(Emri i institucionit/organizata)

Shërbimi i marrë

Keni qenë më parë në një vend tjetër ☐ PO ☐ JO **Specifikoni cili vend** _____

Arsyeja e qëndrimit në vendin përkatës: ☐ Punësim ☐ Studim/formim ☐ Azil ☐ Tjetër

Kohëzgjatja e qëndrimit në vendin përkatës: ☐ 0 – 3 muaj; ☐ 03-12 muaj; ☐ 1-5 vjet ☐ 6-10 vjet
☐ >10 vjet

Kur jeni kthyer në vendin e origjinës? Viti _____

Si mësuat rreth shërbimeve për migracionin dhe diasporën që ofrohen nga bashkia? ☐

Miq të/Familja ☐ Rrjetet sociale

☐ Google/Interneti ☐ Shpallje publike (Postera/Borde) ☐ Media (Radio, TV, Shtypi i shkruar)

☐ Të tjera

Specifiko _____

Çështje me interes për shtetasin:

☐ Informacion rreth kurseve të formimit, profileve dhe ofruesve;

☐ Informacion rreth kurseve të gjuhëve të huaja;

☐ Informacion rreth agjencive të punësimit;

☐ Informacion rreth përkthimit, noterizimit dhe pajisjes me pullë apostile për dokumentacionin e nevojshëm;

☐ Informacion rreth shërbimeve të ofruara në portalin e-Albania dhe mënyrës së përdorimit

☐ Informacion rreth vendndodhjes dhe adresave të ambasadave/zyrave konsullore në vendin pritës;

☐ Informacion rreth mënyrës së marrjes së dokumenteve shkollore dhe certifikatave profesionale/të kurseve, si dhe vlerësimit të tyre për njohje jashtë vendit;

☐ Informacion rreth marrjes së dokumentacionit për vaksinat dhe kryerjes së kontrollit të përgjithshëm mjekësor.

Pyetje specifike për shtetasin:

Do ta rivlerësonit vendimin tuaj për të emigruar?

☐ PO ☐ JO

Nëse PO, për cilat prej shërbimeve të mëposhtme do të ishit të interesuar të merrnit informacion?

☐ Këshillim për punësim

☐ Orientim profesional

☐ Këshillim për arsim

☐ Informacion për nisjen e një biznesi

☐ Informacion për sigurimet shoqërore

☐ Informacion për sigurimin shëndetësor

☐ Mbështetje financiare

☐ Rekomandime për shërbime mjekësore falas

☐ Informacion për alternativat e strehimit

☐ Informacion për shërbimet e ofruara në portalin e-Albania dhe mënyrës së përdorimit të tyre

☐ Informacion rreth investimeve në vend

☐ Informacion rreth mbështetjes së ofruar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

☐ Tjetër

Temat e trajtuara gjatë këshillimit:

☐ Dokumentacioni i nevojshëm

☐ Format i duhur i dokumentacionit

☐ Si të merren dokumentet duke përdorur portalin e-Albania

☐ Ofertat e vlefshme për kurset e formimit profesional dhe të gjuhëve të huaja

☐ Referimi të shërbimeve dhe/ose institucioneve të tjera

☐ Vendndodhjet dhe adresat e institucioneve të referuara për marrjen e informacionit rreth shërbimeve të tjera të nevojshme

PËR T'U PLOTËSUAR NGA PERSONELI ZYRTAR:

Kohëzgjatja e përafërt e seancës së këshillimit

☐ më pak se 5 minuta ☐ 5-10 minuta ☐ 10-20 minuta ☐ 20-30 minuta ☐ më shumë se 30 minuta

DEKLARATA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TATEMENT ON THE PROTECTION OF PERSONAL DATA **DEKLARATA E PËLQIMIT**

Ne, [bashkia e _____], garantojmë që të dhënat personale të mbledhura përmes këtij formulari këshillimi do të trajtohen me fshehtësi dhe siguri të plotë, në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Të dhënat tuaja do të përdoren vetëm për qëllimin e dhënies së informacionit dhe këshillimit për situatën tuaj dhe nuk do të ndahen pa pëlqimin tuaj, përveçse kur kërkohet me ligj. Ju keni të drejtën të kërkonit qasje, korrigjimin apo fshirjen e të dhënave tuaja personale.

Për të tërhequr Deklaratën tuaj të Pëlqimit, ju lutemi dërgoni një mesazh elektronik në adresën: _____.

Me anë të nënshkrimit më poshtë konfirmoj se kam lexuar dhe kuptuar deklaratën për mbrojtjen e të dhënave dhe jap pëlqimin tim për përpunimin e të dhënave të mia personale, në përputhje me këtë deklaratë.

☐ Jam dakord që bashkia e _____ mund t'i ruajë dhe t'i përdorë të dhënat e mia për statistikat e brendshme lidhur me demografinë, statusin e punësimit dhe eksperiencën e migracionit.

☐ Jam dakord që bashkia _____ mund të më kontaktojë pas seancës së këshillimit në numrin e telefonit _____ për të më informuar rreth ecurisë sime.

Deklarata e pëlqimit mbetet e vlefshme për një afat deri në tre vjet nga data e nënshkrimit.

Emri _____ i _____ plotë:

Nr. _____ i _____ telefonit:

Posta _____ elektronike:

Nënshkrimi _____ & _____ Data _____